

U D H E Z I M

Nr. 1 date 21.01.2010

PER

ZBATIMIN E BUXHETIT TE VITIT 2010

Ne mbështetje te pikës 4, te nenit 102 te Kushtetutës, ne zbatim te ligjit nr. 9936, date 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë” dhe te nenit 18 te ligjit nr.10190 datë 26.11.2009, "Për buxhetin e vitit 2010", Ministri i Financave,

U D H E Z O N:

1. RREGULLA TE PERGJITHSHME

1. Buxheti i Shtetit fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Ai detajohet ne nivel vjetor dhe mujor dhe depozitohet për zbatim ne Ministrinë e Financave. Buxheti i vitit 2010 perbehet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale: sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe fondi i kompensimit te pronave.
2. Plani vjetor i buxhetit, akorduar nga Ministria e Financave për buxhetin qendror, buxhetin e pushtetit vendor dhe për fondet speciale ne nivel titulli, kapitulli dhe artikulli, përfaqëson limitin maksimal te lejuar për t'u shpenzuar nga njesite shpenzuese dhe degët e thesarit. Ne mbeshtetje te nenit 42 “ Shperndarja e fondeve buxhetore”, te ligjit 9936 date 26.6.2008 “ Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqiperise”, shperndarja e fondeve buxhetore per njesite e qeverisjes se pergjithshme, per programe dhe zera shpenzimesh, mund te jete me pak se sa totali i fondeve te miratuara nga Kuvendi per ato njesi dhe per periudha me pak se nje vit.
3. Ne nenin 3 te ligjit nr.9936 date 26.6.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Shqiperi”, eshte percaktuar:
 - a) “Qeverisje e pergjithshme”, eshte teresia e njesive te qeverisjes qendrore, vendore dhe te fondeve speciale.
 - b) “Njesi te qeverisjes qendrore”, jane njesite e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqesor, te krijuara me Kushtetute, ligj ose vendim te Keshillit te Ministrave, qe kane si veprimtari te tyre paresore permbushjen e funksioneve te qeverisjes qendrore.
 - c) “Njesi te qeverisjes vendore” jane njesite e niveleve te ndryshme vendore, te krijuara me ligj, qe kane si veprimtari te tyre paresore permbushjen e funksioneve te qeverisjes vendore, brenda nje territori te caktuar.
 - d) “Njesi e fondeve speciale” eshte njesia e krijuar me ligj per te ushtruar funksione specifike te qeverisjes qendrore dhe vendore
 - e) “ Njesi shpenzuese”, eshte njesia me e vogel organizative e njesive te qeverisjes se pergjithshme, per te cilen jane detajuar fondet buxhetore.
4. Kur nëpunësi autorizues dhe/ose nëpunësi zbatues i një njësie shpenzuese të njësisë së qeverisjes së përgjithshme apo nëpunësi i thesarit, lejojnë tejkalimin e fondeve të shpërndara buxhetore, në kundërshtim me nenin 42 të ligjit nr. 9936, date 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, ose kryejnë pagesa, që tejkalojnë fondet e angazhuara në kundërshtim me nenin 54 të këtij ligji, dënohen me gjobë nga nëpunësi i parë autorizues, e cila varion nga 3-7 paga.
5. Ne mbeshtetje te nenit 3 dhe 19, te ligjit nr. 9936, date 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, “Nepunes autorizues” eshte nepunesi i nivelit me te larte i njesive te qeverisjes se pergjithshme:

- a) Nepunes autorizues ne njesite e qeverisjes qendrore eshte punonjesi i administrates publike i nivelit me te larte te sherbimit civil, pra respektivisht Sekretari i Pergjithshem.
 - b) Ne njesite e qeverisjes se pergjithshme, qe nuk jane pjese e pushtetit ekzekutiv, nepunes autorizues eshte punonjesi i nivelit me te larte menaxhues, perkatesisht sekretari i pergjithshem ose titullari (atje ku nuk ekziston pozicioni i sekretarit te pergjithshem).
 - c) Nepunes autorizues ne njesite e qeverisjes vendore eshte kryetari i njesise ose zevendesi i tij, nese kryetari vendos ta delegoje kete pergjegjesi. Sipas ketij percaktimi, nuk mund te jete nepunes autorizues asnje nepunes tjetër, pervec zevendesit direkt te titullarit.
 - d) Nepunesi autorizues i njesise shpenzuese eshte titullari i kesaj njesie. Ligji nuk lejon mundesine e delegimit te ketij funksioni.
6. Ne mbeshtetje te nenit 20, te ligjit nr. 9936, date 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, “ Nepunes zbatues “, eshte punonjesi i administrates publike, i nivelit te larte, te sherbimit civil, te njesise se qeverisjes se pergjithshme, i cili caktohet nga nepunesi autorizues dhe ka vartesi direkte prej tij, ne pozicion jo me te ulet se sa niveli menjehere pas tij ne strukturen organizative te institucionit.
7. Çeljet mujore te buxhetit miratohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, ne Ministrinë e Financave dhe janë te detyrueshme për t’u zbatuar nga degët e thesarit. Ne vitin 2010 do te vazhdoje te veprohet me sistemin e kompjuterizuar te thesarit (AMoFTS). Te ardhurat tatimore ngarkohen ne sistemin AMoFTS nga strukturat e Drejtorisë se Përgjithshme te Tatimeve dhe te Doganave ne nivel 7-shifror te klasifikimit ekonomik buxhetor dhe shërbejnë për rakordim me te dhënat bankare dhe raportim te detajuar te te ardhurave te qeverise. Deri ne venien ne eficence te plote te Sistemit te Automatizuar te Thesarit, perfshire edhe modulën e pagesave nepermjet sistemit bankar, do te vazhdohet te punohet dhe raportohet dhe me sistemin ekzistues. Raportimeve sipas ketij sistemi do t’i shtohen informacionet per transaksionet e brendshme qe nuk shoqerohen me levizje parash. Transaksionet e brendshme perfshijne kategorite e “Xhirimeve te brendshme” dhe “Transferime te brendshme” . Informacioni per kategorine e xhirimeve te brendshme te perfshihet ne raportime si shpenzim ne institucionet dhenese (pa levizje cash) dhe si e ardhur per institucionet perfituese (pa levizje cash). Per kategorine e transferimeve te brendshme, transfertat qe prekin llogarite specike te shpenzimeve (analizat 6040001,6040002,6040005,6041100) dhe te te ardhurave (analizat 7200101,7200102,7200105,7201101) nuk do te perfshihen ne raportime pasi jane per konsolidim.
8. Regjistrimi i realizimit te shpenzimeve dhe te ardhurave buxhetore behet ne nivel 7-shifror te klasifikimit ekonomik dhe klasifikimi funksional detajohet me projekte.

1.1 NUMRI I PUNONJESVE BUXHETORE

9. Numri i punonjësve për njesite e qeverisjes qendrore te pavarura nga Qeveria caktohet ne ligjin vjetor te buxhetit (tabela 1/1), ndërsa për njesite e qeverisjes qendrore numri i punonjësve ne organike dhe numri i punonjësve me kontrate te perkohshme caktohet me Vendimin përkatës te Këshillit te Ministrave, brenda numrit total te punonjësve te miratuar ne ligjin nr.10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010".
10. Për njesite e qeverisjes qendrore te pavarura, çelja dhe depozitimi i numrit te punonjësve sipas tabelës 1/1 te ligjit vjetor te buxhetit, behet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit ne Ministrinë e Financave, pas miratimit te ligjit vjetor te buxhetit. Ndërkohe, çdo njesi e qeverisjes qendrore, ne zbatim te vendimit te Këshillit te Ministrave, detajon sipas strukturës buxhetore, numrin e punonjësve te njesive shpenzuese ne varesi te saj dhe e depoziton atë pranë Drejtorisë se Përgjithshme te Buxhetit, ne Ministrinë e Financave, menjehere pas daljes se vendimit te Këshillit te Ministrave për këtë qellim. Ne rast te kundërt, Ministria e Financave bllokon pagesën e pagave te punonjësve te institucioneve përkatëse. Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, ne mbështetje te detajimit te bere nga çdo njesi e qeverisjes qendrore, depoziton pranë degëve te thesarit numrin e punonjësve për çdo njesi shpenzuese.

Nga ky rregull, përjashtohet depozitimi i numrit të punonjësve të Sh.I.Sh.-it, i cili paraqitet vetëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit. Në të njëjtën mënyrë do të veprohet edhe për numrin e punonjësve të miratuar me kontrate të përkohshme si për njesitë e qeverisjes qendrore të pavarura dhe njesitë e tjera të qeverisjes qendrore. Shpenzimet do të perballohen me fondet e planifikuara në shpenzimet korrente për vitin 2010. Numri i punonjësve buxhetorë të miratuar sipas vendimeve përkatëse do të hidhet në sistem në nivel njesie shpenzuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Degët e thesarit do të hapin në sistemin AMoFTS grupe (batche) të veçanta për punonjësit të miratuar në struktura edhe për punonjësit me kontrate të përkohshme.

11. Në rastet e daljes së akteve ligjore/nënligjore apo ndryshimeve strukturore, të cilat parashikojnë ndryshime në numrin e punonjësve të njesive shpenzuese, njesitë e qeverisjes qendrore, dërgojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, kërkesën për ndryshim të numrit të punonjësve dhe kjo e fundit i depoziton ndryshimet pranë degëve të thesarit, dhe në sistem. Deri në daljen e vendimit të Këshillit të Ministrave për numrin e punonjësve të miratuar në organike për vitin 2010 degët e thesarit veprojnë me numrin e azhurnuar të punonjësve të depozituar në vitin e mëparshëm. Për punonjësit me kontrate të përkohshme do të veprohet pas daljes së vendimit përkatës. Për pagesën e punonjësve mesimore në dispozicion të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe të instruktoresve të formimit profesional të Ministrisë së Punës, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, do të veprohet sipas udhëzimit të veçantë të përgatitur nga vete këto ministri, i cili, pas miratimit paraprak të Ministrisë së Financave, depozitohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit.
12. Degët e thesarit, pasi verifikojnë numrin faktik të punonjësve për çdo njesi shpenzuese, mbështetur në liste-pagesat dhe në numrin e punonjësve të dërguar zyrtarisht (apo në sistem) nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, raportojnë sistematikisht, çdo muaj numrin faktik të punonjësve për të cilët është kryer shpenzimi, si pjesë përbërëse e raportit mujor të zbatimit të buxhetit. Numri i punonjësve që depozitohet dhe raportohet është i lidhur me personelin direkt buxhetor dhe me shpenzimet që kryhen në artikujt 600 (paga) dhe 601 (sigurime shoqërore), si dhe nga të ardhurat.
13. Njesitë e qeverisjes qendrore do të raportojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministri të Financave mbi strukturat e lira, me datë 30 maj dhe 30 gusht të çdo viti. Ministria e Punëve të Jashtme do të raportojë gjithashtu edhe mbi numrin faktik të punonjësve të përfaqësive diplomatike çdo katër-mujor.

1.2 TË TJERA

14. Fondet e nevojshme për përbalimin e kompensimit të energjisë elektrike për punonjësit buxhetorë do të bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.
15. Gjate detajimit të planit të buxhetit, njesitë e qeverisjes qendrore, me parë shpërndajnë fonde për të paguar detyrimet e prapambetura të viteve të kaluara për të gjitha llojet e shpenzimeve (korrente/kapitale).
16. Sherbimi i transportit në njesitë e qeverisjes qendrore, rregullohet sipas ligjit nr 10160, datë 15.10.2009, "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nepunësit civilë". Kufiri i shpenzimeve për shërbimin e transportit për çdo ministri dhe institucion është sipas tabelës 1/3 të ligjit të Buxhetit të vitit 2010.
Ky fond përfshin: shpenzimet e karburantit, mirëmbajtjen e automjeteve, siguracionin dhe kolaudimin, shpenzime këto të cilat janë të planifikuara në artikullin 602 "Për mallra e shërbime". Detajimi i këtij fondi nga ana e njesive të qeverisjes qendrore sipas njesive shpenzuese, të paraqitet në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit.
Përfimi i bonusit për funksionarët e përcaktuar në ligjin e sipërcituar fillon në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës së emertesës shofer dhe heqjes së mjetit për funksionarin dhe perballohet nga fondet me artikullin 606 "Transferi tek buxhetet familjare dhe individët".
17. Njesitë shpenzuese me prioritet urdhërojnë pagesat për shërbimet e furnizimit me energji elektrike dhe ujë.
18. Çelja e Furnitorëve (e Klientëve) në sistemin AMoFTS bëhet në baze të kërkesës së Degës përkatëse të thesarit, (Formati bashkëlidhur), nga Drejtoria e Përgjithshme e thesarit në baze të konfirmimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, (nëpërmjet vënies në dispozicion të

një user-i ne sistemin e tatimpaguesve te saj nga i cili do te gjenerohen printscreen-et e furnitorëve te rinj), e cila duhet te azhornoje sistematikisht listën e MoF për çdo çelje te re te furnitorëve.

Njësitet shpenzuese duhet t'i kërkojnë çdo furnitori formularin e bankës me referencat perkatese kur plotëson dokumentet qe paraqet ne degën e Thesarit për përdorimin e fondeve buxhetore.

Ne rastet e mospërputhjes se te dhënave bankare te furnitorit me ato te sistemit te Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve duhet te komunikojë me sistemin bankar për unifikimin e te dhënave. Ne sistemin AMoFSTS regjistrimi i furnitorit behet me emrin e konfirmuar nga referencat bankare. Ne rast se ne sistemin e tatimpaguesve për një NIPT te caktuar ekziston një emër Furnitori i ndryshëm nga ai i paraqitur ne dokumentet e njësishë shpenzuese ne degën e Thesarit, njësia shpenzuese duhet te kontaktojë me furnitorin për te azhornuar te dhënat ne QKR, degën përkatëse te Tatim-Taksave dhe DPT.

Ne rastet kur kërkohet kohe për azhornimin e te dhënave te furnitorëve ne sistemin e tatimpaguesve ne zbatim te procedurave ekzistuese, për raste emergjente te mbylljes se periudhës etj. do te merret konfirmim me e-mail (pa printscreen) nga DPT.

19. Njësitet e reja shpenzuese, ne listën e sistemit AMoFSTS do te çelen nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe do te bëhen te përdorshme ne modulet e sistemit nga sektorët përgjegjës.
20. Meqenëse kosto e shërbimit parësor shëndetësor është pjese e buxhetit te sigurimeve shëndetësore sistemi i thesarit do te raportoje ne mënyre specifike shpenzimet e bëra nga skema për shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor si pjese përbërëse e raportit te përgjithshëm qe dërgohet nga ISKSH ne Drejtorinë e Përgjithshme te Thesarit, sipas struktures te klasifikimit buxhetor qe zbatohen edhe për njësitet shpenzuese.
21. Strukturat buxhetore te klasifikimit funksional te shpenzimeve çelen ne sistem nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit. Strukturat buxhetore te klasifikimit ekonomik te shpenzimeve do te çelen ne nivel tre-shifror nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe ne nivel te detajuar shtate-shifror nga Drejtoria e Kontabilitetit.
22. Ne rastin e ristrukturimit te njësive shpenzuese, njësitet e qeverisjes qendrore janë te detyruara te kryejnë sistemimin e nevojshëm te fondeve aty ku transferohen funksionet. Ne rastin e shkrirjes se njësive shpenzuese ne fund te vitit, njësia e qeverisjes qendrore duhet te përballoje shpenzimet me fondet e planifikuara për vitin e ardhshëm.
23. Ne kuader te projektit me skemen SWAP fondet e miratuara ne kapitujt 1,2,3 dhe 4 rishperndahen ne kapitullin 7 te programeve perkatese mbi bazen e propozimit te Institucione perkatese dhe disponibilitetit te fondeve te dhena nga donoret. Ne rast rishperndarje fondesh nga ky kapitull ne kapitull 1,3 dhe 4, atehere Institucionet duhet t'i reflektojne keto ndryshime ne raportet e monitorimit te paraqitura prane Drejtorise se Pergjithshme te Buxhetit.
24. Perdorimi i llogarise speciale per fondin e shpronësimit te behet ne perputhje me Udhezimin e Ministrise Financave Nr.7 date 7.05.2007 “ Per perdorimin e fondit te shpronësimeve”.
25. Klasifikimi sipas programeve u dergohet degeve te thesarit ne forme elektronike.

2. PROCEDURAT E DETAJIMIT TE PLANIT

2.1 FONDI I KONSOLIDUAR

26. Njësitet e qeverisjes qendrore, bëjnë detajimin e buxhetit vjetor mbi bazën e Ligjit te buxhetit te vitit 2010, sipas klasifikimit buxhetor ne nivel vjetor për te gjitha njësitet shpenzuese nacionale dhe lokale (për buxhetin e kushtëzuar), deri ne nivel artikulli, sipas Formatit nr.1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Detajimi i Buxhetit dërgohet ne Drejtorinë e Përgjithshme te Buxhetit, ne Ministrinë e Financave, zyrtarisht dhe ne forme elektronike. Pasi miratohet detajimi behet i vlefshëm për zbatim ne degët e thesarit dhe ne sistem.
27. Ne ligjin nr. 10190 date 26.11.2009 “ Per buxhetin e vitit 2010 “ Fondet per universitetet jane te miratuara ne artikullin 604 “Transferta korrente te brendshme” dhe shperndahen ne formen e grantit. Granti per cdo universitet shperndahet ne fillim te vitit nga MASH. Universitetet

nepermjet organeve kolegjiale detajojne kete grant sipas njesive shpenzuese dhe zerave perkates te buxhetit. Plani i detajuar sipas vendimit te Keshillit Administrativ, depozitohet nga universitetet, ne Drejtorine e Pergjithshme te Buxhetit, e cila pasi e rregjistron rishperndarjen e fondeve ne sistemin AMoFTS (ne Kap.08) e dergon per zbatim ne deget e thesarit. Nje kopje e planit te detajuar se bashku me nje kopje te vendimit te Keshillit Administrativ i dergohet Ministrise se Arsimit dhe Shkences. Gjithashtu universitetet duhet te paraqesin prane Drejtorise se Pergjithshme te Thesarit ndarjen e limiteve mujore, e cila, pasi e rregjistron ne sistemin AMoFTS, e dergon per zbatim ne deget e thesareve. Pas ketyre transferimeve fondet per universitetet jane te disponueshme ne cdo dege thesari. Mbeshtetur ne ligjin nr. 9741, date 21.5.2007, "Per arsimin e larte ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, neni 72, transfertat e pakushtezuara, akorduar nga buxheti i shtetit te paperdorura ne fund te vitit 2010, do te merret ne konsiderate ne transferten e pakushtezuar qe do te akordohet nga buxheti i shtetit per vitin pasardhes.

28. Fondi i planifikuar ne Art.604 per Sherbimin Spitalor ne Ministrine e Shendetesise do te detajohet dhe do te perdoret me Vendim te Keshillit te Ministrave. Ne zbatim te VKM-se, ISKSH paraqet ne Drejtorine e Pergjithshme te Buxhetit detajimin sipas strukturave buxhetore te miratuara. Drejtoria e Pergjithshme e Buxhetit dergon kete detajim ne Deget e Thesarit dhe Drejtorine e Pergjithshme te Thesarit, pasi e ka rregjistruar ne sistemin AMOFTS ne kapitullin 08. Gjithashtu, ISKSH paraqet prane Drejtorise se Pergjithshme te Thesarit ndarjen e limiteve mujore, e cila, pasi e rregjistron ne sistemin AMoFTS, e dergon per zbatim ne deget e Thesarit. Pas ketyre transferimeve fondet per spitalet jane te disponueshme ne cdo dege thesari. Ky transferim konsiderohet ne kontabilitet si grant per ISKSH. Shpenzimet e mesiperme nuk do te perfshihen ne raportin mujor dhe vjetor te perpiluar nga ISKSH qe paraqitet ne Drejtorine e Pergjithshme te Thesarit.
29. Ne zbatim te ligjit 10190 date 26.11.2009 " Per buxhetin e vitit 2010 fondet per QKR dhe QKL jane te planifikuara ne artikullin 604 ne planin e Ministrise Ekonomise dhe Energjitikes. Fondet e QKR-se per QR e Bashkive si edhe fondet e QKL per QL te Bashkive, pas detajimit per artikujt 600, 601 dhe 602, paraqiten ne Drejtorine e Pergjithshme te Buxhetit per rishperndarje sipas strukture buxhetore perkatese. Drejtoria e Pergjithshme e Buxhetit e dergon kete rishperndarje ne Deget e thesarit dhe Drejtorine e Pergjithshme te Thesarit pasi e ka rregjistruar ne sistemin AMoFTS ne kapitullin 08. Gjithashtu QKR dhe QKL dergon ne Drejtorine e Pergjithshme te Thesarit ndarjen e limiteve mujore, e cila pasi e rregjistron ne sistemin AMoFTS e dergon per zbatim ne Deget e Thesarit.
30. Për efekt te ndjekjes se buxhetit ne funksion te menaxhimit te likuiditeteve te qeverise, plani i detajuar ne nivel njesie shpenzuese, do te detajohet edhe ne periudha mujore, i ndare ne dy grupe artikujsh: shpenzime te personelit dhe shpenzime te tjera (ku përfshihen shpenzimet korrente dhe kapitale) dhe përkatësisht për dy grup kapitujt: 1+3+4, sipas formatit bashkëlidhur. Totali i detajimeve te buxhetit ne nivel mujor sipas njesive shpenzuese duhet te jete i barabarte me shumen mujore te shpenzimeve për njesine e qeverisjes se pergjithshme, te përcaktuar me pare ne bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme te Thesarit. Detajimet mujore dërgohen ne Drejtorinë e Përgjithshme te Thesarit ne forme te printuar dhe ne forme elektronike. Drejtoria e Thesarit u dërgon degëve ne rrethe detajimet mujore vetëm për grup kapitujt: 1+3+4 ne forme te printuar dhe elektronike për njesite shpenzuese qe veprojnë ne juridiksionin e tyre. Ne kuadrin e zbatimit te sistemit AMoFTS, personi i autorizuar zyrtarisht nga njesia e qeverisjes qendrore, për buxhetin, te paraqitet ne Drejtorinë e Thesarit ku do te regjistrojë (up-load) te dhënat ne sistemin AMoFTS, nen mbikëqyrjen e një përfaqësuesi te Drejtorisë se Thesarit.
31. Kufijtë maksimale mujore për shpenzim janë te rishikueshem gjate vitit. Me kërkesë te argumentuar nga ministritë/institucionet qendrore dhe vendore, ose drejtpërdrejt nga Drejtoria e Thesarit, brenda 10-ditëve te fundit te muajit, bazuar ne likuiditetet e disponueshme te llogarise se Qeverise, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit rishikon ne zmadhim/reduktim, miraton dhe azhiron kufijtë maksimale mujore te lejuar për shpenzim.
32. Për qëllimet e rakordimit te informacionit me sistemin AMoFTS degët e thesarit, pas depozitimit te çeljeve buxhetore nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, procedojnë me regjistrimin e planit vjetor te buxhetit dhe limitit

mujor për njesi shpenzuese, sipas strukturës buxhetore të miratuar, i cili përben planin e miratuar me ligj dhe kufirin maksimal për t'u shpenzuar sipas llogarive ekonomike.

33. Dega e Thesarit me paraqitjen të Urdhër pagesave për shpenzim nga njesia shpenzuese, kryen kontrollin e ekzistencës së limitit mujor të lejuar për shpenzim. Ky kontroll realizohet në sistemin AMoFTS, sipas zërave agregate të çelur me parë. Nëse nuk ka limit të mjaftueshëm mujor shpenzimi nuk aprovohet.
34. Ministritë detajojnë buxhetin deri në nivelin me të ulët të njesive shpenzuese dhe e depozitojnë në Ministrinë e Financave, duke mos lejuar detajim të mëtejshëm nga urdhëruesit e shkallës së dytë. Ministritë dhe institucionet qendrore janë të detyruara të çelin të gjitha fondet buxhetore me specifikat si më poshtë:
 - Fondet e Nxitjes së Punësimit, bëhen efektiv në degët e thesarit vetëm pas konfirmimit nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit mbi projektet fituese, menjëherë pas lidhjes së kontratës.
 - Fondi Rezerve i Këshillit të Ministrave, Fondi i Kontigjencës dhe fondi rezerve për rritjen e pagave dhe pensione, depozitohen në degën e thesarit Tirane.
 - Fondi për shërbimin e borxhit (interesa dhe principal) dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit të Ministrisë së Financave dhe përdoret mbi bazën e autorizimeve të miratuara nga Ministri i Financave.
 - Fondet për blerjen e pajisjeve elektronike dhe për çdo projekt tjetër që lidhet me IT, bëhen efektive pas konfirmimit nga Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit (AKSHI).
35. Detajimi i planit vjetor të shpenzimeve me burim të ardhurat e veta për njesi shpenzuese, bëhet në të njëjtën mënyrë si për shpenzimet e tjera buxhetore. Ky detajim dërgohet nga njesitë e qeverisjes qendrore në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave e prej këtej në degët e thesarit.

2.2 DETAJIMI DHE CELJA E FONDEVE PËR INVESTIME

36. Plani i investimeve, i miratuar me ligjin nr.10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", tabela 1, në nivel vjetor dhe sipas programeve, u dërgohet nga Ministria e Financave për detajim të mëtejshëm Njesive të Qeverisjes Qendrore. Plani i investimeve i detajuar nga Njesitë e Qeverisjes Qendrore në nivel projekti, në përputhje me totalin, sipas programeve miratuar me ligjin e buxhetit, dërgohet për miratim në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit (Drejtorinë e Menaxhimit të Investimeve Publike) të Ministrisë së Financave, sipas formatit bashkëngjitur. Plani i miratuar për çdo projekt investimi regjistrohet në sistem nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit (Drejtorinë e Menaxhimit të Investimeve Publike) dhe dërgohet për zbatim në degët e Thesarit.
37. Të gjitha njesitë e Qeverisjes Qendrore, në detajimin e investimeve do të mbajnë parasysh këtë rradhë prioritare:
 - Investimet në proces nga viti 2009
 - Objektet e investimeve të paraqitura në Kuvend, gjatë shqyrtimit të buxhetit 2010
 - Bashkëfinancimet e buxhetit të shtetit në projektet me financime të huaja
 - Investimet sipas prioriteteve sektoriale të miratuara në PBA 2010-2012
38. Nëse në listën e investimeve të detajuara nga Ministritë dhe Institucionet Qendrore, ka objekte të reja nga lista e paraqitur në momentin e miratimit të buxhetit të vitit 2010, Ministria e Financave e përfshin në listën përfundimtare vetëm kur objekti është pjesë e PBA 2010-2012 dhe ka kaluar në procedurat e Ciklit të Menaxhimit të Investimeve Publike. Në rast se vlera e projektit është mbi 50 milionë leke, përfshirja në listë bëhet pasi ka kaluar procedurat e miratimit të investimeve publike.
39. Nëse në listën e detajuar të projekteve të investimeve nga buxheti, nga Njesitë e Qeverisjes Qendrore, listohen projekte që paraqesin kontrata të punimeve shtese, celja e tyre do të bëhet vetëm pas miratimit nga Ministria e Financave bazuar në dokumentacionin e detajuar justifikues/argumentues mbi domosdoshmerinë e tyre. Kjo procedure do të jetë e vlefshme edhe për rastin e rialokimeve të projekteve gjatë zbatimit të buxhetit.

40. Ne buxhetin e Ministrisë se Arsimit dhe te Shkencës për vitin 2010, janë të planifikuar fondet për investime për arsimin universitar në formën e fondeve për zhvillimin e rajoneve. Sipas aneksit Nr. 3 të ligjit Nr 10 190 datë 26.11.2009 “Për Buxhetin e vitit 2010”, Institucionet e arsimit të lartë do të përfitojnë këto fonde nëpërmjet paraqitjes së projekteve pranë Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës dhe të vlerësimit nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve. Institucionet e arsimit të lartë mund të bashkefinancojnë për objekte investimesh edhe nga të ardhurat e veta. Për objektet e reja institucionet e arsimit të lartë duhet të marrin paraprakisht miratimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës. Institucionet e arsimit të lartë respektojnë standardet e vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, e cila monitoron, vlerëson dhe kontrollon zbatimin e standardeve të vendosura nga ajo për rikonstruksion, ndërtim dhe pajisje të ambienteve të arsimit universitar.
41. Këshillave përkatëse të organeve të qeverisjes vendore u rekomandohet të ndjekin këto rregulla kur miratohet detajimi i investimeve sipas projekteve, si pjesë e buxhetit vendor.
42. Njesite shpenzuese, pasi marrin fondin e planifikuar për projektin e investimit, zbatojnë procedurat e prokurimit, lidhin kontratën me palën sipërmarrëse dhe mbajnë përgjegjësi për hartimin e kësaj kontrate në përputhje me legjislacionin në fuqi. Njesite shpenzuese, janë të detyruara të paraqesin në degët e Thesarit kontratat e lidhura në gjuhën shqipe, menjëherë pas lidhjes së saj. Degët e Thesarit nuk mbajnë përgjegjësi për ligjshmërinë e procedurave të prokurimit, përfshirë këtu dhe regjistrin e prokurimeve.
43. Degët e Thesarit, pasi marrin planin e investimeve në nivelin e projektit nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, (Drejtoria e Menaxhimit të Investimeve Publike), autorizojnë përdorimin e tij, vetëm pasi kontrollojnë dhe regjistrojnë kontratën origjinale të lidhur midis palëve. Për raste specifike siç janë investimet që kanë të bëjnë me konservim, mbyllje e projekte studimore, vepohet në baze të instruksioneve përkatëse të Ministrisë së Financave dhe/ose Njesive të Qeverisjes Qendrore.
44. Ndalohej përdorimi i formës së ngurtësimit në llogari të klientit për të gjitha kontratat (investime, shërbime). Në lidhjen e kontratave për investime nuk lejohet të parashikohet dhënia e fondeve buxhetore në formën e paradhënies, përveç rasteve kur parashikohet në kontratë me referencë të specifikuar të aktit ligjor/ nën ligjor. Në këto raste paradhënia mund të jete deri në 10%, por jo më shumë se kufiri i garancisë së kontratës. Perjashtimet nga ky rregull mund të behen vetëm për kontrata të rendesise së vecante me miratim të Ministrisë së Financave
45. Për investimet që përballohen nga të ardhurat e veta të Njesive Shpenzuese, Njesite e Qeverisjes Qendrore nga ata varen, autorizojnë, çeljen me objekte dhe përdorimin e tyre sipas kritereve të përcaktuara me akte ligjore dhe nënligjore që lidhen me rregullat e prokurimit publik. Dega e Thesarit bën çeljen e fondit vetëm pas konfirmimit të realizimit të të ardhurave. Të ardhurat e pushtetit vendor për investime ndjekin rregulla specifike të përcaktuara në pikën 4.
46. Investimet për Fondet e Zhvillimit Rajonal të infrastruktures vendore çelen në strukturën Ministria e Linjes 00, Program xxxxx, Kapitull 05, të specifikuar me kode projekti. Shkresat e çeljes së këtyre fondeve do të hidhen në sistemin AMoFTS nga degët e thesarit në rrethe. Njësitet e qeverisjes vendore nuk kanë të drejtën e ndryshimit të emërimit të projekteve.

2.3 DETAJIMI DHE CELJA E FONDEVE PËR INVESTIMET ME FINANCIM TË HUAJ

47. Me qëllim që të sigurohet një përputhje sa më e plotë midis programit të investimeve me financim të huaj dhe raportimit faktik të tyre, të gjitha Njesitet e Qeverisjes Qendrore që kanë financime të huaja detajojnë, së bashku me investimet e brendshme në projekte edhe ato të huaja dhe i dërgojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit (Drejtorinë e Menaxhimit të Investimeve Publike) për miratim, e cila pasi shqyrton përputhshmerinë me treguesit e ligjit të buxhetit të vitit 2010 dhe politikat e miratuara në Kuvend, planin e miratuar e dërgon për zbatim në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit dhe në degët e thesarit.
48. Për projektet me financim të huaj mund të zbatohen procedurat e ndryshme raportimi në varësi të specifikimeve të bëra nga Drejtoria e Thesarit në Ministrinë e Financave (procedura

te pjesshme thesari/ procedura te plota thesari). Për projektet me financim te huaj, për te cilat nuk raportohet nëpërmjet sistemit te Thesarit, njësite e zbatimit te projekteve apo drejtoritë e buxhetit/financës ne Njesite e Qeverisjes Qendrore janë te detyruara, te dërgojnë raportet e tyre mujore dhe progresive ne Drejtorinë e Përgjithshme te Thesarit te Ministrisë se Financave, brenda datës 5 te muajit pasardhës, sipas formatit bashkengjitur.

49. Fondet përkatëse nga financimi i huaj, si për rastin kur funksionojnë sipas skemës se plote te Thesarit ashtu edhe kur funksionojnë sipas skemës se pjesshme, kur nuk përdoren brenda vitit buxhetor, mbarten ne vitin pasardhës dhe nuk i nënshtrohen kufizimeve te tjera qe zbatohen për fondet buxhetore sipas këtij udhëzimi.
50. Për financimet e huaja qe zbatohen sipas skemës e plote te Thesarit, Drejtoria e Thesarit miraton kërkesën për shperndarje nga njësia e menaxhimit/zbatimit te projektit, bazuar ne aktmarrëveshjet e lidhura dhe konfirmimet për disbursimin e fondeve ne Bankën e Shqipërisë. Kufiri maksimal për shpenzim dërgohet nga Drejtoria e Thesarit ne degët e thesarit për zbatim, sipas formatit bashkengjitur. Për fondet e papërdorura nga viti i kaluar buxhetor, degët e thesarit ne fillim te vitit 2010 bëjnë automatikisht çeljen e fondit te mbartur për shpenzim (diferenca plan-fakt 2009).

2.4 FONDET SPECIALE

51. Ne Fondet Speciale përfshihen fondi per sigurimet shoqërore, fondi per sigurimet shëndetësore dhe fondi per kompensimin e pronave. Detajimi i transfertes se buxhetit te shtetit për Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Institutin e Sigurimeve te Kujdesit Shëndetësor, behet nga vete institucioni dhe depozitohet ne Drejtorinë e Përgjithshme te Thesarit, e cila e dërgon ne degët e thesarit, sipas afateve dhe procedurave te përcaktuara me sipër. Menytrat, rregullat dhe procedurat e arketimit dhe administrimit te burimeve te fondit te kompensimit te pronave do te percaktohen me udhezim te vecante te Ministrit te Financave.

3. PROCEDURAT E ZBATIMIT TE BUXHETIT

3.1. RISHPERNDARJA E FONDEVE BUXHETORE

52. Rishperndarja e fondeve buxhetore eshte pjese e procesit te azhornimit te politikave te programuara ne fillim te vitit dhe te detajuara mbi bazën e një strukture standarde buxhetore. Për këtë arsye rishperndarja e fondeve buxhetore korrente nga një kapitull dhe artikull ne një tjetër, brenda te njëjtit program, miratohet nga nepunesi i pare autorizues/Ministri i Financave. Perjashtimisht, përdorimi i fondit te vecante, i cili është pjese e artikullit 600, ne rastet kur përdoret për nevoja te tjera, përveç shpërblimeve, transferohet nga vete njesite (qendrore dhe te varësisë) nga artikulli 600 ne artikujt 602 dhe 606, sipas natyrës se shpenzimit. Rishperndarja e fondeve te projekteve te investimeve brenda te njejtit program te njesise se qeverisjes qendrore miratohen nga Ministri i Financave, pas argumentimit te plote nga institucioni kërkues sipas formatit bashkengjitur. Rishperndarjet e mësipërme miratohen ne nivel vjetor, regjistrohesh nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, ne sistemin AMoFTS dhe dërgohen për zbatim ne Degët e Thesarit. Drejtoria e Pergjithshme Thesarit bën shtimin/pakësimin e limitit mujor te institucionit ne sistem AMoFTS. Rishperndarjet e fondeve nga një program ne tjetrin, brenda te njëjtës Njesi te Qeverisjes Qendrore, apo midis programeve te Njesive te ndryshme te Qeverisjes Qendrore, bëhen vetëm me miratim te Këshillit te Ministrave dhe nuk tejkalojne 10% te totalit te programit te miratuar. Transferimet, ne zbatim te VKM-ve, kryhen ne përputhje me procedurat për transferimin e fondeve.
53. Rishperndarjet brenda te njejtit program, kapitull dhe artikull te shpenzimeve korente, ndermjet njesive te ndryshme shpenzuese, miratohen nga nepunesi autorizues i njesise se qeverisjes qendrore, nga e cila varet njesia shpenzuese. Njesia e Qeverisjes Qendrore paraqet zyrtarisht dhe elektronikisht kerkesen per rishperndarje fondesh se bashku me konfirmimet per pakesim. Drejtoria e Pergjithshme e Buxhetit konfirmon kerkesen per rishperndarje vetem pas regjistrimit ne sistemin AMoFTS. Njesia e Qeverisjes Qendrore i dergon Degeve te Thesarit

dhe njesive shpenzuese nje kopje te shkreses te konfirmuar. Gjithashtu paraqet ne Drejtorine e Pergjithshme te Thesarit kerkesen per ndryshimin e limitit mujor te shpenzimeve, ne mbeshtetje te shkreses se konfirmuar. Drejtoria e Pergjithshme Thesarit ben shtimin/pakësimin e limitit mujor te institucionit ne sistem AMoFTS dhe njofton elektronikisht Deget e Thesarit. Dega e thesarit pasi e kontrollon fondin ne sistemin AMoFTS kryen procedurat e perdorimit te fondeve. Keto rishperndarje do te behen nje here ne dy muaj. Numri i rishperndarjeve per çdo Njesi te Qeverisjes Qendrore është pjese e treguesve per vlerësimin e zbatimit te buxhetit per institucionin.

54. Kërkesa për rishperndarje fondesh shoqërohet, detyrimisht, me një kopje te konfirmimit te degës se thesarit ku do te behet pakësimi i fondit. Degët e thesarit, janë te detyruara t'u përgjigjen për çdo rast kërkesave te njesive te qeverisjes qendrore për te konfirmuar pakësimin, menjehere me mbërritjen e kërkesës. Dega e Thesarit pas dhënies se konfirmimit nuk procedon me pranimin e urdhër pagesave te njesise shpenzuese nga fondi respektiv. Njesite e Qeverisjes Qendrore janë te detyruara qe te gjitha rishperndarjet ne nivel vjetor dhe ne nivel mujor, si dhe avancimet e fondeve buxhetore nga një muaj ne tjetrin, t'i sjellin zyrtarisht dhe elektronikisht njëkohësisht duke qene përdorues ne Sistemin AMoFTS.

3.2 FONDET E KUSHTEZUARA

55. Fondet e kushtëzuara te krijuara nga te ardhurat e institucioneve dhe te papërdorura ne fund te vitit, nuk mbarten ne vitin e ardhshëm buxhetor, me përjashtim te te ardhurave te pushtetit vendor, te ardhurave te institucioneve te arsimit te larte, te ardhurave te spitaleve dhe te ardhurave jashtë limitit te përcaktuara ne piken 3.4. Ne rastet kur, sistemi AMoFTS ka probleme ne funksionimin e tij, per sigurimin e mbarevajtjes se punes, regjistrimi i te ardhurave te trashegueshme do te behet ne menyre manuale.
56. Procedurat e transferimit për limitin e përdorimit te te ardhurave, janë te njëjta me ato te shpenzimeve te tjera buxhetore. Njesite e Qeverisjes Qendrore, lejohen te transferojnë edhe te ardhura te krijuara nga një institucion buxhetor i varësisë ne një tjetër, gjithnjë shoqëruar me konfirmimin e degës se thesarit ku behet pakësimi. E njëjta procedure zbatohet edhe nga Ministria e Mbrojtjes për strukturat e saj vartëse, si dhe nga Zyra Qendrore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme, duke ruajtur kriteret e përdorimit sipas akteve ligjore e nënligjore ne fuqi. Degët e Thesarit nuk lejojnë kryerjen e shpenzimeve mbi limitin vjetor te përdorimit te te ardhurave edhe pse niveli i mbledhjes se tyre nuk kufizohet gjate vitit buxhetor. Autorizimi për kryerjen e shpenzimeve nga te ardhurat behet nga degët e thesarit ne përputhje me sasinë e mbledhur te tyre. Ky autorizim përben kufirin maksimal te lejuar për shpenzim nga te ardhurat e institucionit. Përdorimi i tyre rregullohet me udhëzime te përbashkëta te Ministrisë se Financave me Ministrinë e Linjës/Institucionet Qendrore. Procedura e përdorimit mbështetet ne aktet e rakordimit sipas formatit bashkengjitur.

3.3 TE ARDHURAT

57. Te ardhurat tatimore qe krijojnë institucionet gjate aktivitetit te tyre, por qe mblidhen nga te tretet (ne rolin e agentit tatimor), te cilët i arkëtojnë ne llogarinë bankare te te ardhurave te sistemit tatimor (siç është rasti i Radio-Televizionit për taksen e përdorimit te aparateve radiotelevizive, e cila mblidhet nga filiali elektrik etj.) do te përdoren nga institucioni përkatës sipas legjislacionit ne fuqi, kundrejt paraqitjes ne degën përkatëse te Thesarit te akt-rakordimit te mbajtur midis Institucionit dhe Drejtorive Rajonale te Tatimeve (i cili përmban shumen e te ardhurave te arkëtuara për periudhën e kërkuar dhe shumen e pjesëmarrjes për përdorim nga agjenti tatimor). Dega e Thesarit akordon për përdorim për shumen qe i takon Institucionit përkatës. Ne rastin kur institucioni nuk ka dege ne rrethe, siç është rasti i Radio-Televizionit, akt-rakordimi mbahet midis Drejtorisë se Përgjithshme te Radio-Televizionit dhe Drejtorisë se Përgjithshme te Tatimeve dhe akordimi i fondit behet nga Dega e Thesarit Tirane ku kryhen transaksionet nga Drejtoria e Përgjithshme e Radio-Televizionit.

58. Te ardhurat e krijuara nga institucionet buxhetore i nënshtrohen kriterëve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.432 date 28.6.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore” dhe udhëzimeve përkatëse të dala në zbatim të tij. Kur institucionet buxhetore janë agjente tatimore, të ardhurat e realizuara nga ky aktivitet trajtohen si të ardhura nga veprimtaria kryesore dhe derdhen 100% në buxhetin e shtetit.
59. Për institucionet buxhetore - agjente tatimore që të ardhurat tatimore i arkëtojnë në llogarinë e të ardhurave të degës së Thesarit (si p.sh. Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve), Drejtoria Rajonale e Tatimeve kur përpilon raportin mujor merr nga dega e Thesarit konfirmimin për shumën mujore të arkëtuar për taksën përkatëse dhe, pasi e kontabilizon, e paraqet në një rresht të veçante të formatit të raportimit. Raportimi mujor i firmosur nga Dega e Thesarit dhe e Tatimeve, dorëzohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për efekt të realizimit të planit të të ardhurave tatimore.
60. Për eliminimin e transfertave fizike të parave ndërmjet llogarive të qeverisë, kur të ardhurat tatimore derdhen gabimisht në llogarinë bankare të të ardhurave jotatimore në emër të degës së thesarit, nuk behet transferte fizike midis dy llogarive bankare. Drejtoria Rajonale e Tatimeve kur përpilon raportin mujor merr nga dega e Thesarit konfirmimin për shumën mujore të arkëtuar për taksën përkatëse dhe, pasi e kontabilizon, e paraqet në një rresht të veçante të formatit të raportimit. Raportimi mujor i firmosur nga Dega e Thesarit dhe e Tatimeve, dorëzohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për efekt të realizimit të planit të të ardhurave tatimore.
61. Në rastin e mbylljes së degëve dhe shkrirjes së tyre me Qendrën, dega e Thesarit të rrethit të Qendrës kryen transaksione nga të ardhurat e degës në baze të akt-rakordimit (bashkangjitur kopjen e dokumentit bankar përkatës të arkëtimit) të lëshuar nga dega e Thesarit që mbulonte degën e shkrirë tashme.
62. Për akordimin e fondeve nga të ardhurat e pagesës për legalizim të ndërtimeve pa leje të përcaktuar në aktet ligjore përkatëse, Dega Thesarit e Qendrës Rajonale dhe Zyra Rajonale e ALUIZNI-it bëjnë akt-rakordimin mujor, të cilit i bashkëlidhet lista e njësisë vendore ku ndodhet objekti informal me shumën e detajuar për çdo njësi vendore të rezultuar nga rakordimi midis ALUIZNI-it dhe Njesisë vendore. Zyra rajonale e ALUIZNI-it e përcjelle një kopje të akt-rakordimit të konfirmuar zyrtarisht nga dega përkatëse e Thesarit dhe kërkesën për rritjen e autorizuar të fondeve buxhetore në Zyrën Qendrore të ALUIZNI-it në Tiranë. Dega Thesarit e Qendrës Rajonale autorizon sipas kërkesës për rritjen e autorizuar të konfirmuar zyrtarisht nga Drejtoria Përgjithshme e Zyrës Qendrore të ALUIZNI-it. Për fondet që shpenzohen nga njësi vendore, kërkesa e rritjes së autorizuar të konfirmuar zyrtarisht nga Drejtoria Përgjithshme e Zyrës Qendrore të ALUIZNI-it do të dërgohet në degët e Thesarit të rrethit ku ndodhen njësi vendore nga Zyra përkatëse Rajonale e ALUIZNI-it. Dega Thesarit e rrethit (jo e Qendrës Rajonale) do t'i akordoje fondet njësisë vendore sipas shumave të autorizuar në kërkesën e rritjes së autorizuar të konfirmuar zyrtarisht nga Drejtoria Përgjithshme e Zyrës Qendrore të ALUIZNI-it.

3.4 TE ARDHURAT JASHTË LIMITIT

63. Te ardhurat jashtë limitit, evidentohen, me strukture të veçante buxhetore (Kapitulli 6) Në të ardhurat jashtë limitit përfshihen:
- Te ardhurat që mblidhen nga Zyrat e Përmbarimit për llogari të të treteve.
 - Paradhëniet për pjesëmarrje në ankand dhe garancitë bankare (kur janë të kthyeshme)
 - Sponsorizime me destinacion të përcaktuar nga donatori.
 - Arketimet e paidentifikuara deri në sistemin e tyre.
 - Arketimet e gabuara që duhen rikthyer kur vërtetohen si të tilla.
 - Arketimet e perkohshme nga penaltetet deri në marrjen e vendimit të formës së prere.
 - Arketimet nga kërkesat ankimore të sistemit doganor.
 - Te ardhurat që institucionet sportive arkëtojnë nga pjesa që u takon me ligj nga Llotosporti ose nga sponsorizimet e tjera.
 - Te ardhurat nga agjente tatimore që nuk janë institucione buxhetore.

- Mjetet ne ruajtje për sipërmarrësit lidhur me shumen e garancisë se punimeve për defektet, te mbajtur sipërmarrësit mbi vlerën totale te situacionit përfundimtar te investimit sipas kontratës;
 - Te ardhurat nga privatizimi, nga te cilat paguhen vendimet gjyqësore për privatizimet nga MoF, dhe detyrimet e tjera te lidhura me te.
 - Te ardhurat nga arsimi i larte.
 - Te ardhurat nga spitalet
64. Te ardhurat e përcaktuara me sipër, mbarten ne vitin buxhetor pasardhës mbi bazën e rakordimit qe institucioni bën me degën e Thesarit e cila e mbulon. Fondet e papërdorura nga viti i kaluar, çelen automatikisht nga dega e thesarit (diferenca plan-fakt 2009).Te ardhura jashtë limitit qe nuk mbarten ne vitin buxhetor pasardhës janë:
- Te ardhurat nga vendosja e sanksioneve dhe shitjes se mallrave te konfiskuara te zbatimit te ligjit nr. 8449 date 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës se Shqipërisë".
 - Te ardhurat nga ankandet për mallrat kontrabande.

3.5 PER FONDIN E VECANTE

65. Përlllogaritja e Fondit te Veçante dhe përdorimi i tij, behet sipas Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 1151 Date 25.11.2009 dhe Udhëzimit nr.50 date 9.12.2009 « Mbi krijimin dhe perdorimin e fondit te vecante nga njesite e qeverisjes se pergjithshme”. Përdorimi i fondit te veçante, i cili është pjese e artikullit 600, ne rastet kur përdoret për nevoja te tjera, përveç shpërblimeve, transferohet nga vete njesite (qendrore dhe te varësisë) nga artikulli 600 ne artikujt 602 dhe 606, sipas natyrës se shpenzimit. Dega e thesarit përkatëse i paraqet paraprakisht nje kopje te ketyre transferimeve ne Drejtorinë e Përgjithshme te Buxhetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme te Thesarit, rast pas rasti, per rregjistrim ne sistemin AMoFTS. Njesite shpenzuese, njëkohësisht, njoftojnë për këto transferime njesit e qeverisjes qendrore nga te cilat varen.

3.6 RAPORTET E MONITORIMIT

66. Nepunesit autorizues te njesive te qeverisjes qendrore, duhet te paraqesin tek nepunesi i pare autorizues, brenda datës 28 te muajit pasardhës te çdo tremujori, informacion te detajuar mbi performancën e produkteve te buxhetit 2010. Per performancën e produkteve te buxhetit te vitit 2009 raporti i monitorimit nga njesite e qeverisjes qendrore, do te paraqitet brenda datës 30.01.2010 mbi bazen e te dhenave operative qe disponojne dhe me pas edhe ne muajin prill 2010, mbeshtetur ne te dhenat perfundimtare, pas rakordimeve me Ministrine e Financave. Rregullat për te menaxhuar dhe raportuar mbi performancën e produkteve janë specifikuar ne mënyre te detajuar, ne udhëzimin e Ministrisë te Financave, “Për zbatimin e procedurave te monitorimit”. Raportet e monitorimit duhet te përfshijnë informacion mbi arritjet ne terma sasiore dhe vlerore te produkteve te realizuara; te identifikojnë mosarritjet dhe te shpjegojnë shkaqet e tyre duke propozuar ne te njëjtën kohe masa për përmirësimin e situatës. Formatet e raportimit janë ato qe rrjedhin nga softi i PBA-se (raportet e monitorimit). Gjithashtu nepunesit autorizues te njesive te qeverisjes qendrore, duhet t’i paraqesin nepunesit te pare autorizues ne mënyre periodike, çdo tre muaj, brenda datës 28 te muajit pasardhës te çdo tremujori, informacion te detajuar ne nivel projekti, për realizimin e investimeve publike me financim te brendshëm dhe te huaj, sipas formateve bashkelidhur. Raportet e monitorimit te buxhetit do te publikohen ne faqen zyrtare te Ministrise Financave çdo 3 mujor.

3.7 SUBVENCIONET

67. Për te gjitha llojet e subvencioneve, zbatohen udhëzimet që lidhen me planifikimin dhe zbatimin e tyre, të cilat ndryshojnë kur lind nevoja e përmirësimit të procedurave, rregullave apo afateve. Çelja e fondit të planifikuar për subvencion për vitin 2010 do të kushtëzohet nga miratimi i këtij subvencioni nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore. Subvencioni nuk do të çelët pa marrë miratimin nga ky komision me përjashtim të subvencioneve për tekstet shkollorë, shërbimet qeveritare. Dhënia e subvencionit bëhet sipas afateve të përcaktuara në udhëzimet përkatëse, por duke respektuar detajimin e subvencionit në periudha mujore. Çelja e fondeve të subvencionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit bëhet për institucionin dhënës dhe jo për përfutuesin. Kalimi i shumës së subvencionit në llogarinë bankare të përfutuesit kryhet me urdhër të institucionit dhënës duke zbatuar procedurat përkatëse. Dhënia e kështu të parë bëhet sipas planit në formë paradhënie, ndërsa në rastet e tjera dhënia e subvencionit bëhet sipas situacionit, jo me shumë se plani, duke zbritur diferencën e situacionit të periudhës së mëparshme. Në asnjë rast subvencioni nuk jepet me tepër nga plani. Kur situacioni i periudhës së mëparshme paraqitet me tejkalim, ai nuk merret parasysh. Institucioni dhënës i subvencionit (ministra e linjës, institucioni buxhetor, organi i qeverisjes vendore), përveç situacionit, kërkon edhe një kopje të dokumenteve justifikuese bashkëlidhur me të. Institucioni dhënës i subvencionit ka detyrim të ushtroje kontroll dhe të kërkojë ekspertim për situacionet dhe dokumentacionin përkatës. Në rast të kundërt, institucioni dhënës bën pezullimin e dhënies së fondeve të reja për subvencionin.

3.8. FONDI REZERVE I BUXHETIT TË SHETIT

68. Sipas nenit 5 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, Fondi rezerve përdoret: " Vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave"

Në zbatim të këtij neni, kërkesa e ministrave të linjës për përdorimin e këtij fondi kalon në këto faza:

- (i) Ministrinë e linjës paraqesin në Ministrinë e Financave një projekt, me të cilën argumentojnë: nevojat për shtesë fondesh, pamundësinë për tu përballuar nëpërmjet rialokimit të fondeve brenda sistemit nisur nga analiza e realizimit të buxhetit për periudhën raportuese, emergjencën e problemit dhe pamundësimet e parashikimit në procesin buxhetor, etj.
- (ii) Ministria e Financave, pas analizës së saj, jep vërejtjet dhe sugjerimet, të cilat duhet të sqarohen dhe të plotësohen detyrimisht kur të përgatitet projekt-vendimi përfundimtar.
- (iii) Me mendimin e ministrave të interesuara bashkëlidhur dhe aprovimin e Ministrisë së Financave, projektvendimi paraqitet në Këshillin e Ministrave.

3.9 SHPENZIMET NË VALUTE

69. Shpenzimet në valute janë pjesë përbërëse e buxhetit në leke të institucioneve buxhetore miratuar me ligjin vjetor të buxhetit të shtetit. Degët e thesarit autorizojnë blerjen e valutës deri në kufirin e autorizuar nga Ministri i Financave, sipas shkresës nr.2633 datë 6.3.2009 të Ministrisë së Financave dhe Udhëzimit nr. 40 datë 1.10.2009 " Për pagesat direkt nga banka e Shqipërisë në valute", kundrejt buxhetit të miratuar në leke. Të gjitha Ministrinë dhe Institucionet Qendrore, në fund të çdo tremujori, brenda datës 10 të muajit pasardhës paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit pranë Ministrisë së Financave, situacionin faktik tremujor, progresiv të shpenzimeve jo tregtare në valute, të detajuara sipas natyrës së shpenzimeve.

3.10 MARREDHENIET E SISTEMIT TË THESARIT ME NJESITË SHPENZUESE

70. Për ekzekutimin e transaksioneve të shpenzimeve publike njësite shpenzuese duhet të paraqesin paraprakisht në degët e Thesarit kontratat e lidhura ndërmjet palëve ose urdhrat e prokurimit për blerjet e vogla. Me regjistrimin në sistemin AMoFTS të dokumenteve të mësipërme behet bllokimi i fondeve (regjistrohet angazhimi) për shpenzim. Dega e Thesarit vendos mbi dokument numrin elektronik të vendosur nga sistemi, i cili duhet respektuar nga njësia shpenzuese në kërkesën për shpenzim.
71. Për të ardhurat jotatimore që krijohen gjatë vitit, njësite shpenzuese duhet të pajisin paraprakisht individët/subjektet me "Fature arkëtimi" dhe një kopje të saj e dërgojnë në degët respektive të Thesarit. Individët/subjektet duhet të paraqiten në sportelet e bankave për të realizuar derdhjen/transferten e mjeteve monetare në llogarite të Thesarit. Për arketimet mbi 1000 leke, institucionet buxhetore duhet të operojnë nepermjet sistemit bankar ose shërbimit postar (në baze të një marrëveshje të institucioneve me postën)
72. Njësite buxhetore do të informohen periodikisht nga degët e thesarit për pagesat e kryera dhe të ardhurat e arkëtuara sipas formatit bashkëngjitur. Formatit dorëzohet në formë të printuar dhe të konfirmuar zyrtarisht nga dega e Thesarit në kushtet e mundësimit nga sistemi AMoFTS. Degët e thesarit nuk janë të detyruar të ofrojnë informacion ministrive të linjës për njësite vartëse dhe njësite të pushtetit vendor dhe rajonal. Informacion i detajuar me njësi buxhetore është disponibel në faqen e website: www.minfin.gov.al. (Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit)

4. BUXHETET E PAVARURA

4.1 BUXHETI I PUSHTETIT VENDOR

73. Hartimi dhe zbatimi i buxhetit vendor bazohet në dispozitat e ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", akte të tjera ligjore, si dhe akte nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre.
74. Në zbatim të ligjit nr.10190 date 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", Ministri i Financës me shkresën nr. 1310, date 9.12.2009, "Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e planifikuar për vitin 2010", ka njoftuar të gjitha njësitë e qeverisjes vendore për transferten e pakushtëzuar për vitin 2010. Në transferten e pakushtëzuar të bashkive, Berat, Çorovode, Peshkopi, Burrel, Durrës, Gjirokastër, Tepelene, Përmet, Fier, Lushnjë, Elbasan, Cërrik, Gramsh, Korçë, Erseke, Leskovik, Lezhe, Rrëshen, Rubik, Kukës, Krumë, Shkodër, Puke, Tiranë, Vlorë dhe të komunave, Qendër Fier, Golem Kavajë, Kelmend Malësi e Madhe janë të përfshira edhe fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit të konvikteve të arsimit parauniversitar. Në transfertën e pakushtëzuar të bashkive, Berat, Elbasan, Kuçovë dhe Kukes janë të përfshira edhe fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit shërbyes dhe shpenzime operative për qendrat, "Lira", Berat, "Balash", Elbasan, dhe qendrat ditore të fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për Bashkinë Kuçovë dhe Kukes. Mbi këtë bazë çdo njësi e qeverisjes vendore rishikon dhe përgatit buxhetin përfundimtar për miratim në Këshillin e saj. Buxheti i miratuar nga këshilli depozitohet në degën e thesarit në përputhje me rregullat dhe formatet e kërkuara nga kjo e fundit për regjistrim në Sistemin AMoFTS. Deri në miratimin e buxhetit nga këshilli, njësitë e qeverisjes vendore do të vazhdojnë të kryejnë çdo muaj shpenzime deri në masën e 1/12 se nivelit të transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurave të veta të miratuara në vitin 2009.
75. Në buxhetin e njësite të qeverisjes vendore, do të pasqyrohen të gjitha të ardhurat, shpenzimet dhe financimet në pushtetin vendor. Buxheti vendor është unik, të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten sipas shërbimeve dhe zërave, pavarësisht nga burimi i financimit. Fondet e kushtëzuara për financimin e funksioneve që nuk janë transferuar ose deleguar tek njësite e qeverisjes vendore nuk janë të ardhura vendore dhe nuk miratohen si pjesë përbërëse e buxhetit të njësisë vendore përkatëse. Këshillat duhet të vendosin vetëm për objektet me të cilat do të konkurrohet për përfitimin e graveve konkurruese, megjithëse këto fonde janë të kushtëzuara. Buxheti vendor është i balancuar, përveç rasteve kur merret hua për financimin e

projekteve të investimeve. Buxheti vendor është i balancuar në termat e arkëtimeve dhe të pagesave.

76. Ne baze të ligjit nr. 9869, datë 4.02.2008, "Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore", dhe nenit 58 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", njësitë e qeverisjes vendore kanë të drejtë të marrin hua. Rregullat, kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për marrjen hua nga njësitë e qeverisjes vendore; si dhe transparenca, bashkëpunimi dhe raportimi me strukturat e qeverisjes qendrore janë në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 35, datë 5.11.2008, "Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 4.02.2008, "Për huamarrjen e qeverisjes vendore".

77. Te ardhurat e miratuara në buxhetin e njësitë të qeverisjes vendore do të përfshijnë:

- Te ardhurat nga taksa mbi biznesin e vogël
Te ardhurat e parashikuara sipas sistemit të taksave vendore të përcaktuara me ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", ndryshuar me ligjin nr.9764, datë 09.07.2007 "Për disa ndryshime në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", ndryshuar me ligjin nr.9745 datë 28.05.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore". Ligji **Nr. 9931**, datë 09.06.2008 "**Për disa ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006**", Ligji **Nr.10073**, datë 09.02.2009 "**Për një shtesë në ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006**", Ligji **Nr.10117**, datë 23.04.2009 "**Për disa ndryshime në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006** , Ligji **Nr.10146**, datë 28.09.2009 "**Per disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 9632, datë 30.10.2006**"
- Te ardhurat jo-tatimore ku futen: të ardhurat nga shërbimet e ndryshme, të ardhurat nga shitja dhe dhënia me qera e pronave (trojeve etj), nga kontributet, sponsorizimet, gjobat,etj.
- Te ardhura nga huaja e tregut financiar ose bankar brenda ose jashtë vendit
- Te ardhurat e krijuara nga institucionet që janë në varësi të qeverisjes vendore, të cilat përdoren nga vete institucioni ku krijohen.
- Te ardhurat nga qenia si agjent tatimor.
- Te ardhurat nga gjobat dhe penalitetet e ndryshme.
- Te ardhurat nga kuotat e anëtarësisë së komunave dhe bashkive për këshillin e qarkut.
- Transferta e pakushtëzuar nga pushteti qendror dhe,
- Transferta e kushtëzuar nga pushteti qendror (për funksione që miratohen në buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore).

78. Te ardhurat e arkëtuara nga ALUIZNI, në procesin e legalizimeve sipas ligjit nr. 9482, datë 3.04.2006, "Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar. Procedurat dhe mënyra e përdorimit të këtyre të ardhurave janë të saktësuara në udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 37, datë 20.11.2008, "Për përdorimin e të ardhurave nga procedurat e legalizimit".

79. Shpenzimet e miratuara në buxhetin e njësitë të qeverisjes vendore do të përfshijnë:

- Shpenzimet për funksionet e veta (ekskluzive).
- Shpenzimet për funksionet e deleguara.
- Shpenzimet për funksionet e përbashkëta.

Ne shpenzimet për funksionet e veta, do të përfshihen: Shpenzimet e çdo natyre ekonomike që parashikohen të bëhen për:

- Administratën vendore
- Shërbimet publike si: pastrim, gjelbërim, dekor, funeral, ndriçim qyteti, etj.
- Institucionet vendore të kulturës dhe sportit.
- Mirëmbajtjen dhe ndërtimin e rrugëve lokale dhe trotuareve.
- Transportin urban.
- Financimin e degëve të shoqatës së të Verbërve nga këshillat e qarqeve (Siç parashikohet në VKM nr. 549 datë 7.11.2002 "Për një ndryshim në VKM nr. 277 datë 18.06.1997 "Për përfitime nga statusi i të verbrit".

80. Shpenzimet për subvencionim të Ujësellsve. Gjate vitit 2010 funksioni i furnizimit me ujë të pijshëm dhe të kanalizimeve do të kryhet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi:

Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 660, datë 12.09.2007 “Për Transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve njësite të qeverisjes vendore”, VKM nr. 677 datë 03.10.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 642, datë 11.10.2005 të Këshillit të Ministrave për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive anonime shtetërore”, dhe VKM nr. 678 datë 03.10.2007 “Për një shtese në Vendimin nr. 271, datë 09.05.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime shtetërore””. Fondet për subvencionimin e ujësjellësve janë të planifikuara në buxhetin e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit e Telekomunikacionit, cila bën shpërndarjen e këtij subvencioni në buxhetin e njësite të qeverisjes vendore brenda 10 ditëve nga miratimi i Ministrisë së Financave. Shuma e subvencionit do të përcaktohet dhe do të përdoret në përputhje me Udhëzimin nr. 6569 datë 27.06.2006 “Për kriteret e procedurat për përdorimin e subvencioneve shtetërore për sh.a dhe ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve.

Ne shpenzimet për funksionet e deleguara do të përfshihen:

81. **Shpenzimet për mbrojtjen sociale** Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, detajon në fillim të vitit 2010, fondet e mbrojtjes sociale për çdo njësi të qeverisjes vendore, në mënyrë specifike për ndihmën ekonomike dhe për pagesën e paaftësisë. Njësite e qeverisjes vendore janë të detyruara të respektojnë destinacionin e përcaktuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Fondet e mbrojtjes sociale delegohen, si transferte e kushtëzuara, për çdo njësi të qeverisjes vendore që në fillim të vitit, në përputhje me afatet e përcaktuara në kapitullin 2 të këtij udhëzimi. MPCS&SHB mund të mbajë një fond deri në 5% të pashpërndarë në fillim të vitit nga fondi i mbrojtjes sociale për të siguruar financimin e rasteve të paparashikuara. Në çdo rast shpërndarja e këtij fondi duhet të jetë transparente dhe mbi baze kriteresh të përcaktuara.

Fondet e ndihmës ekonomike dhe të paaftësisë që shpërndahen në njësite të qeverisjes vendore, si dhe kriteret e parimet e përdorura për shpërndarjen e tyre bëhen publike për të gjitha bashkitë dhe komunat.

82. **Shpenzimet për përkujdesjen shoqërore** Financimi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror, që realizohet nga bashkitë, komunat dhe qarku, do të bëhen nga buxheti i shtetit, si dhe të ardhurat vendore. Fondet nga buxheti jepen në formën fondeve të kushtëzuara nga Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta që në fillim të vitit, në përputhje me afatet e përcaktuara në kapitullin 2 të këtij udhëzimi. Bashkitë dhe komunat administrojnë shërbimet e përkujdesit shoqëror për qendra të përkujdesit që u shërbejnë individëve, banorë të bashkisë ose komunës si dhe shërbimet e përkujdesit për këta individë. Qarqet administrojnë shërbimet e përkujdesit shoqëror për qendra të përkujdesit që u shërbejnë individëve të disa njësite të qeverisjes vendore në përbërje të qarkut.

83. Shpenzimet që kryhen nga njësite të qeverisjes vendore për llogari të pushtetit qendror, nuk janë shpenzime vendore dhe nuk miratohen në buxhetin vendor nga këshilli përkatës. Përveç sa më sipër, këtu përfshihen:

- Shpenzimet për shërbimin e gjendjes civile.
- Shpenzimet për seksionet e administrimit të tokës pranë qarqeve.
- Shpenzimet për sekretaret e deputeteve
- Shpenzimet për punonjësit e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit (QKR) dhe Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) për ato njësi që kanë sportele të QR-se dhe QL .

84. Në shpenzimet për funksionet e përbashkëta do të përfshihen shpenzimet e çdo natyre ekonomike që parashikohen të bëhen në:

Arsim:

- *Funksionimi dhe mirëmbajtja e ambienteve të arsimit para-universitar.* Bashkitë dhe komunat kanë kompetencë të plote për të siguruar mirëmbajtjen dhe funksionimin e të gjitha ambienteve të arsimit parauniversitar në komunitetin e tyre. Fondet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e ambienteve të arsimit parauniversitar janë të përfshira në burimet e veta vendore. Çdo bashki dhe komune vendos nivelin e financimit që ajo akordon për këtë funksion nga të gjitha burimet e disponueshme në buxhetin e tyre. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës përgatit dhe nxjerr standarde kombëtare të sigurisë dhe të shëndetit të zbatueshme për ambientet e arsimit para-universitar. Këto standarde nuk duhet të kufizojnë vendimmarrjen

e bashkive dhe komunave ne fushat me interes te qarte vendor. Shpenzimet e lidhura me funksionimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve te arsimit para-universitar miratohen si pjese e buxhetit te çdo bashkie dhe komune.

- *Konviktet e arsimit parauniversitar*: Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre konvikteve (duke përfshirë edhe punonjësit edukativ zëvendës drejtor dhe edukator), njësite e qeverisjes vendore do të mbështeten në kuadrin rregullator që ka përdorur Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësite e qeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.
- *Investimi*: Ne buxhetin e Ministrisë se Arsimit dhe te Shkencës për vitin 2010, janë te planifikuar fondet për investime për arsimin parauniversitar ne Fondin per Zhvillimin e Rajoneve. Njësite e qeverisjes vendore do te përfitojnë këto fonde nëpërmjet paraqitjes se projekteve pranë Ministrisë se Arsimit dhe te Shkencës dhe te vlerësimit te tyre nga Komiteti i Zhvillimit te Rajoneve krijuar për këtë qëllim, nëpërmjet konkurrimit, dhe ne përputhje me Aneksin 3 te Ligjit nr. 10190 date 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”. Njësite e qeverisjes vendore mund te financojnë edhe nga te ardhurat e veta ne arsimin parauniversitar. Për objektet e reja njësite e qeverisjes vendore duhet te marrin paraprakisht miratimin e Ministrisë se Arsimit dhe te Shkencës. Njësite e qeverisjes vendore respektojnë standardet e vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, e cila nëpërmjet Drejtorive Arsimore monitoron, vlerëson dhe kontrollon zbatimin e standardeve te vendosura nga ajo për rikonstruksion, ndërtim dhe pajisje te ambienteve te arsimit parauniversitar.

Shëndetësi.

- *Investimet*. Ne buxhetin e Ministrisë se Shëndetësisë për vitin 2010 janë te planifikuara fondet për investime për qendrat shëndetësore dhe ambulancave te shërbimit parësor shëndetësor ne Fondin per Zhvillimin e Rajoneve. Njësite e qeverisjes vendore do te përfitojnë këto fonde nëpërmjet paraqitjes se projekteve pranë Ministrisë se Shëndetësisë dhe te vlerësimit te tyre nga Komiteti i Zhvillimit te Rajoneve i krijuar për këtë qëllim, nëpërmjet konkurrimit, dhe ne përputhje me Aneksin 3 te Ligjit nr. 10190 date 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”. Njësite e qeverisjes vendore mund te financojnë edhe nga te ardhurat e veta për ndërtim, rikonstruksion dhe te qendrave shëndetësore dhe ambulancave te shërbimit parësor shëndetësor. Për objektet e reja njësite e qeverisjes vendore duhet te marrin paraprakisht miratimin e Ministrisë se Shëndetësisë. Njësite e qeverisjes vendore respektojnë standardet e vendosura nga Ministria e Shëndetësisë, e cila monitoron, vlerëson dhe kontrollon zbatimin e standardeve te vendosura nga ajo për rikonstruksion, ndërtim dhe pajisje te qendrave shëndetësore dhe ambulancave për shërbimin parësor.
85. **Fondet për zhvillimin e rajoneve.** Ne baze te Aneksit nr.3 te ligjit 10190 date 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, per shpërndarjen e fondeve te rajoneve ngrihet komiteti vlereresimit dhe miratimit te projekteve.

Aplikimi për fonde bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, duke i dërguar projektet në:

- Fondin Shqiptar të Zhvillimit për objektet e infrastrukturës vendore.
- Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për objektet arsimore.
- Ministrinë e Shëndetësisë për objektet shëndetësore.
- Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për objektet e ujësjellës kanalizimeve.
- Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për objektet ndërtim tregjesh agro-ushqimorë, thertoresh dhe objekte për ujitje/kullim.
- Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për objektet kulturore.
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave.

Nje kopje e shkrese percjellese te aplikimeve qe u dergohet nga njësit vendore ministrive dhe institucioneve te mesiperme duhet ti dergohet edhe Ministrise se Financave.

Në ministritë përkatëse qe disponojne dhe menaxhojne fonde per zhvillimin e rajoneve, ngrihen sekretariate teknike që bëjnë vlerësimin tekniko-ekonomik dhe listimin e projekteve të

propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore dhe hartojnë një raport ku përshkruhet procedura e ndjekur, si dhe kriteret e zbatuara.

Ne Ministrinë e Financave krijohet Sekretariati Teknik për përgatitjen dhe paraqitjen e materialit në Komitetin e Zhvillimit të Rajoneve. Sekretariati Teknik në Ministrinë e Financave bashkëpunon me sekretariatet teknike përkatëse të Ministrive të linjës.

Këshillat e Qarqeve paraqesin në Sekretariatit Teknik të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve në Ministrinë e Financave prioritetet e investimeve sipas fushave përkatëse që mbulon Komitetit i Zhvillimit të Rajoneve. si edhe, pjesën e bashkefinancimeve me fonde vendore të fondeve të donatoreve.

Ne lidhje me procedura me të hollësishme për menaxhimin e fondit të zhvillimit të rajoneve do të ketë një udhëzim të veçantë.

Për fondet e miratuara për objekte në vazhdim nga viti 2009, Ministrinë e Linjës bëjnë parashikimin e limiteve mujore në thesar duke u bazuar në kushtin që financimi i këtyre objekteve të bëhet brenda përfundimit të kontratës së lidhur. Në rast të moszbatimit të këtij kushti Drejtorja e Thesarit, në ndryshimin automatikisht me kërkesë të Drejtorisë së Menaxhimit të Investimeve Publike në sistem, pa kërkesën e Ministrisë së Linjës.

Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, dërgon vendimin në Ministrinë e Financave për fondet e miratuara për njësitë e qeverisjes vendore, e cila mbi këtë bazë, bën çeljen në degët e thesarit. Në rastin e projekteve në vazhdim me kontrata të lidhura, të cilat në bazë të realizimit me ritme të shpejta kanë mundësi absorbimi/realizimi të një vlere më të madhe se ajo e alokuar, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, në një nga mbledhjet e tij të para, autorizon ministrinë përkatëse të linjës për të propozuar pranë Ministrisë së Financave të drejtën e kalimit të fondeve në këto projekte, nga projektet që nuk e garantojnë realizimin e tyre apo edhe nga fonde të papërdorura. Projektet në vazhdim të infrastrukturës lokale dërgohen për vlerësim në FSHZH.

Monitorimi dhe kontrolli i zbatimit të fondeve të zhvillimit të rajoneve do të bëhet nga drejtoritë përkatëse në secilën nga ministrinë përfituese. Për fondet e infrastrukturës vendore ngarkohet Ministria e Brendshme. Raportet për ecurinë e zbatimit të projekteve të akorduara njësisë të qeverisjes vendore nga fondet e zhvillimit të rajoneve do të dërgohen në Ministrinë e Financave çdo tre muaj.

Njësitë të qeverisjes vendore raportojnë menjëherë pas lidhjes së kontratës (kur fillon një projekt i ri) për emertimin dhe vlerën e kontratës si dhe një herë në tre muaj në Ministrinë e Brendshme të dhenat e mëposhteme:

- Emri, data dhe vlera e kontraktimit të projektit
 - Shumen e shpenzimeve të kryera për projektin të konfirmuar nga dega e thesarit
 - Situacioni përfundimtar i projektit dhe Akt-marrje në dorëzim
86. **Detajimi dhe çelja e fondeve për investime.** Bashkitë/komunat dhe qarqet në detajimin e investimeve do të mbajnë parasysh këtë radhë prioritare:
- Investimet sipas prioritetëve sektoriale të miratuara në strategjitë vendore të hartuara nga këto të fundit
 - Investimet në proces nga viti 2009
 - Mbështetjen me kosto lokale të investimeve të huaja

Këshilli i njësisë vendore miraton programet e investimeve, sipas prioritetëve të zhvillimit të bashkisë/komunës dhe qarkut. Nëse investimet nuk miratohen nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore në nivel projekti, pas miratimit të programeve kryesore të investimeve nga Këshilli, kryetari i bashkisë/komunës ose qarkut kryen detajimin e programeve në nivel projekti, sipas parametrave të caktuar nga këshilli, duke njoftuar për këtë qëllim këshillin në mbledhjen e ardhshme të radhës.

87. **Te ardhurat e qarqeve nga kuota e njësive vendore.** Në bazë të ligjit nr.8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” nëni 18 njësitë e qeverisjes vendore derdhen një kuote për llogaritë të Këshillit të Qarkut. Kjo kuote do të përcaktohet nga vete njësitë vendore, sipas vendimmarrjes në këshillin e njësisë vendore. Akt-rakordimi i mbajtur midis njësive vendore dhe Degës së Thesarit do të regjistrohet si pakësim i “Pjesës së Institucionit” të njësive përkatëse vendore që derdhen kuotën në shtesë të “Pjesës së

Institucionit” te Këshillit te Qarkut (për te cilin totali i arkëtuar do te jete 0). Këshilli i Qarkut e përdor me rritje te autorizuar nga te ardhurat tek shpenzimet. Për njësite vendore qe nuk ndodhen ne rrethin e Këshillit te Qarkut, Dega përkatëse e Thesarit te njësisë vendore do t’ja transferoje akt-rakordimin Degës se Thesarit ne rrethin e Këshillit te Qarkut, e cila e regjistron ne “Pjesën e institucionit “ te Këshillit te Qarkut.

TE TJERA

88. Njësite e qeverisjes vendore mund te përdorin fondet e pakushtëzuara për te financuar edhe funksione qe financohen me fonde te kushtëzuara. Transferata e pakushtëzuar qe nuk përdoret plotësisht gjate vitit buxhetor mbartet për vitin e ardhshëm.
89. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli, do te bazohet tek numri i punonjësve qe vendoset nga këshilli i njësisë se qeverisjes vendore dhe nga nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi page ne përputhje me aktet nënligjore ne fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal te miratuar. Çdo rritje, brenda kufirit maksimal te miratuar, duhet te behet me kushtin qe 1) te ruhet niveli i shpenzimeve te vitit te mëparshëm për shërbimet publike dhe 2) te rritet niveli i te ardhurave vendore ne raport me vitin e kaluar.
90. Huamarrja per pushtetin vendor, nga tregu i brendshem dhe i jashtem, do te jete e kushtëzuar nga; 1) limiti i borxhit publik, 2) performanca e treguesve fiskale te njesive vendore dhe 3) vleresimi me shkrim i Ministrise Financave per cdo aplikim rast pas rasti.
91. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve te pushtetit vendor do bëhen sipas Vendimit te Këshillit te Ministrave nr.1619, date 2.07.2008, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësite te qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve te pagave te punonjësve te organeve te qeverisjes vendore”, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit te Ministrave nr. 598, date 27.04.2009, “Për disa ndryshime ne Vendimin nr. 1619, date 2.07.2008, te Këshillit te Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësite te qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve te pagave te punonjësve te organeve te qeverisjes vendore”.
92. Njësite e qeverisjes vendore, zbatojnë edhe detyrimet financiare qe rrjedhin nga vendimet gjyqësore për te cilat ato janë ngarkuar ose ngarkohen nga këto vendime, ne përputhje me VKM nr 335 date 02.06.1998 "Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet qe prekin buxhetin e shtetit".
93. Ne miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave te shpenzimeve me pare do te mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj miratohen fondet për te financuar veprimtarinë e vitit ne vazhdim.
94. Sherbimi i transportit per punonjesit e njesive te qeverisjes vendore, rregullohet sipas ligjit nr 10160, date 15.10.2009, “Per rregullimin e shërbimit te transportit per funksionaret publike dhe nepunesit civile”. Kryetaret e Bashkive dhe Kryetaret e Keshillave te qarqeve, perfitojne nje financim mujor, i cili do te jepet sipas neneve 2 dhe 5 te ligjit nr 10160, date 15.10.2009.
95. **Fondi Rezerve dhe Fondi i Kontigjences.** Bazuar në nenin nr.19/7.a.iii të ligjit nr.8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe nenit 6 te ligjit nr.9936, date 26.06.2008, Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësite të qeverisjes vendore, krijohet Fondi Rezervë, për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontigjences. Te dy këto fonde miratohen në masën deri ne 3 (tre) për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara.
96. **Fondi i kompensimit.** Njësite e qeverisjes vendore dërgojnë ne Ministrinë e Financave, kërkesa dhe te dhëna për përfitim nga fondit i kompensimit. Ministria e Financave pranon dhe bën vlerësimin e këtyre kërkesave, ne përputhje me kriteret e përcaktuara ne aneksin nr.2 te ligjit nr.10190 date 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”. .Pas vlerësimeve dhe verifikimeve te nevojshme për kërkesat e njësite te qeverisjes vendore për fonde kompensuese Ministria e Financave bën alokimin e tyre.
97. **Transferata e Kushtëzuar** Transferata e kushtëzuar ne buxhetin e vitit 2010, është dhëne për financimin e një pjese te shpenzimeve për funksionet e përbashkëta dhe për financimin e

shpenzimeve për funksionet e deleguara. Këto fonde do të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin ato janë miratuar. Kjo do të thotë që këto janë fonde të ministrive/institucioneve qendrore dhe për transferimin e tyre nga një njësi e qeverisjes vendore në një tjetër do të veprohet sipas rregullave të përgjithshme të transferimit të fondeve buxhetore. Njësitë e qeverisjes vendore nuk mund të përdorin për qëllime të tjera, përveç atyre të përcaktuara në ligjin nr.10190 date 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”. Shumat prej këtyre transfertave, të mbetura të papërdorura në fund të vitit buxhetor, nuk mbarten në vitin pasardhës.

98. **Fondet nga huaja vendore për financimin e projekteve të investimit** regjistrohen si një zë më vete dhe raportohet periodikisht sipas aneksit B të udhëzimit nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e ligjit numër 9869, datë 4.2.2008, Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore”. Nëse si garanci për huanë vendore është vendosur Interceptimi i Financimit, Njësia vendore depoziton një kopje të marrëveshjes së huasë dhe/ose të marrëveshjes së interceptimit me bankën përkatëse pranë degës së thesarit ku kryen veprimet buxhetore njësia vendore në fjalë. Në rast mospërbushjeje të detyrimeve kontraktuale midis bankës/institucionit financiar dega e thesarit me kërkesë të kredidhënësit zbaton urdhrin e pagesës së kështit të papaguar sipas parashikimit kontraktual duke prekur të ardhurat e pakushtëzuara (të ardhurat nga taksat; tarifat; të ardhura të tjera jotatimore si dhe grantin e pakushtëzuar) të njësisë vendore në fjalë.

PROCEDURAT E ZBATIMIT TE BUXHETIT VENDOR 2010

99. Buxheti, së bashku me anekset përkatëse dhe me vendimin e këshillit, brenda 7 ditëve nga miratimi, duhet të dërgohet në Prefekturën e Qarkut. Pas verifikimit të vendimit të këshillit për buxhetin nga Prefekti i Qarkut në përputhje me kompetencat sipas ligjit nr. 8927 date 25.7.2002 “Për Prefektin”, edhe në rastin kur Prefekti e ka kthyer pa miratim, por këshilli nuk e merr parasysh vendimin e Prefektit, pasqyrat e buxhetit vjetor (të ardhurat sipas burimit të tyre dhe shpenzimet), dërgohen në degën e thesarit për zbatim. Pas miratimit të programit të investimeve (në nivel programi apo projekti) nga Këshilli i njësisë vendore dhe miratimit të tij nga Prefektura, nëse investimet janë miratuar në nivel programi, kryetari i njësisë vendore brenda 10 ditëve kryen detajimin e investimeve publike sipas programeve të miratuara nga Këshilli dhe njofton Degën e Thesarit për zbatim.
100. Dega e thesarit pasi regjistron në Sistemin AMoFTS detajimin vjetor të buxhetit të njësive të qeverisjes vendore sipas strukturave buxhetore, dërgon në Drejtorinë e Thesarit detajimin mujor të grandit të vitit 2010 për çdo njësi të qeverisjes vendore. Procedura e detajimit mujor dhe kontrollit të kufirit maksimal mujor të lejuar për shpenzim kryhet sipas paragrafit nr.2.
101. Degët e thesarit ndihmojnë në procesin e detajimit mujor të planit nëpërmjet përgatitjes së përmbledhëseve për institucionet vendore të rrethit dhe dërgimit në Drejtorinë e Thesarit për miratim. Edhe në rastin e pushtetit vendor, përdorimi i buxhetit do të jete në përputhje të plote me rregullat dhe procedurat e Sistemit AMoFTS
102. Transferta e pakushtëzuar, së bashku me të ardhurat e veta të njësive të qeverisjes vendore do të regjistrohen në thesar si të ardhura të njësisë vendore. Shpenzimet e këtyre fondeve do të pasqyrohen në strukturën përkatëse buxhetore, vetëm në kapitullin 5. Thesari autorizon vetëm ato shpenzime vendore, të cilat janë të përfshira në buxhetin e njësisë vendore të miratuar nga këshilli përkatës i saj.
103. Njësitë e qeverisjes vendore duhet të depozitojnë strukturën dhe numrin e punonjësve në degën përkatëse të thesarit krahas me depozitim të vendimit të këshillit të kësaj njësie për miratimin e buxhetit si dhe brenda datës 31 mars 2010, të dërgojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit (Drejtorinë e Marrëdhënieve Fiskale Ndërqeveritare) numrin e punonjësve për çdo njësi të qeverisjes vendore sipas tabelës nr. XX bashkalidhur.
104. Për njësitë e qeverisjes vendore, kur buxheti miratohet në nivel programi rishpërndarjet:
- ndërmjet programeve miratohen nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore;
 - ndërmjet projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program, miratohen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore;
 - ndërmjet zërave të shpenzimeve korrente, brenda të njëjtit program, miratohen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore;

- brenda të njëjtit program dhe zërit të shpenzimeve korrente, ndërmjet njësive të ndryshme shpenzuese, miratohen nga nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes vendore, nga e cila varet njësia shpenzuese.
105. Çdo ndryshim i buxhetit gjate vitit do te ndjeke te njëjtën rruge procedurale te miratimit te buxhetit ne fillim te vitit. Njësite e qeverisjes vendore, kane te drejte, sipas ligjit te qeverisjes vendore, te bëjnë rishikimin e buxhetit te miratuar ne përputhje me realizimin e te ardhurave dhe me ndryshimin e prioriteteve gjate vitit.
 106. Ne zbatim te nenit 15 te ligjit nr. 10190 date 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, njësite e qeverisjes vendore, i bëjnë publike te gjitha vendimet e këshillave te organeve te pushtetit vendor qe kane te bëjnë me përdorimin e fondeve qe i vihen ne dispozicion nga pushteti qendror, si dhe te fondeve te krijuara nga burimet e veta.
 107. Sipas ligjit nr. 9936, date 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, nëpunës autorizues në njësitë e qeverisjes vendore është kryetari i njësisë ose zëvendësi i tij, nëse kryetari vendos ta delegojë këtë përgjegjësi.
 108. Nëpunësi autorizues i njësive të qeverisjes vendore përgjigjet dhe raporton përpara nëpunësit të parë autorizues për zbatimin e buxhetit të njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, në ushtrimin, nga njësitë e qeverisjes vendore të funksioneve të përbashkëta dhe të deleguara, nga një njësi e qeverisjes qendrore.
 109. Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes vendore përgjigjet dhe raporton përpara komitetit të financës dhe këshillit të njësisë së qeverisjes vendore për zbatimin e buxhetit për të gjitha funksionet e njësive të qeverisjes vendore.
 110. Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes vendore mund të caktojë një punonjës të administratës publike si nëpunës autorizues të nivelit të dytë në njësitë e qeverisjes vendore. Nëpunësi zbatues ka përgjegjësinë për zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar, mbajtjen e llogarive dhe për përgatitjen e pasqyrave financiare.
 111. Nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes vendore i paraqesin, sa herë që kërkohet, por jo më pak se katër herë në vit, këshillit përkatës raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm.
 112. Ne fillimin e vitit fiskal njësite e qeverisjes vendore duhet te depozitojnë ne degët e thesarit vendimin e këshillit bashkiak/komunal dhe te këshillit te qarkut për buxhetin e vitit fiskal ne te cilin duhet te raportohet analitikisht plani i te ardhurave dhe i shpenzimeve.

4.2 BUXHETI I SIGURIMEVE SHOQERORE

113. Buxheti i shtetit, transferon ne buxhetin e sigurimeve shoqerore, kontributet per sigurimin shoqeror, per kategorite e meposhtme:
 - Personat qe kryejne sherbimin e detyrueshem ushtarak. Kontributet llogariten ne baze te pages se realizuar nga ushtaraku para se te fillonte sherbimin e detyrueshem dhe normes se kontributit per degen e pensioneve dhe barreldnjeve, te caktuara ne ligjin nr.7703 date 11.05.1993 “Per Sigurimet Shoqerore ne Republikën e Shqiperise”, i ndryshuar. Ne rastet kur personat qe kryejne sherbimin ushtarak nuk kane punuar me perpara se te mbaronin sherbimin kontributet llogariten mbi bazen e pages minimale te percaktuar me VKM. Instituti i Sigurimeve Shoqerore depoziton ne degen e Thesarit Tirane, planin vjetor te kontributeve per ushtaret, te ndare ne muaj. Financimet nga buxheti behen, çdo muaj, sipas planit. Brenda dates 10 te muajt Prill, Gusht dhe Dhjetor, ISSH paraqet ne degen e Thesarit, evidencen e numrit mesatar te ushtareve per katermujorin te derguar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme. Mbi bazen e ketij numri behet llogaritja e kontributeve te 4-mujorit. Diferencat midis financimeve te terhequra sipas planit dhe financimeve faktike, sistemohen ne muajin fundit te çdo katermujori. Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme, dergojne prane ISSH, listat emerore te ushtareve per efekt te evidentimit te periudhes se sigurimit brenda muajit janar te vitit pasardhes. Per personat qe trajtohen me pagese papunesie, kontributet llogariten mbi pagen minimale te percaktuara sipas ligjit nr. 7703 date 11.05.1993 “Per Sigurimet Shoqerore ne Republikën e Shqiperise”.

- Personat qe trajtohen me pagese deri ne nje vit, per shkak te nderprerjes se mardhenjeve te punes. Kontributet individuale llogariten ne baze te pages se realizuar nga ushtaraku para se te fillonte sherbimin e detyrueshem dhe normes se kontributit per degen e pensioneve dhe barreindjeve, te caktuara ne ligjin nr.7703 date 11.05.1993 “Per Sigurimet Shoqerore ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar. ISSH njofton ne degen e Thesarit per çdo muaj ne momentin e terheqjes se financimeve, numrin e personave qe trajtohen me pagese papunesie te konfirmuar dhe nga Sherbimi Kombetar i Punesimit dhe shumen e kontributit . Mbi bazen e kesaj evidence dhe kerkeses se ISSH behet kalimi nga buxheti i shtetit ne buxhetin e pavarur te sigurimeve shoqerore.
- Personat qe trajtohen me pagese kalimtare, sipas ligjit nr. 8097 date 21.03.1996 “Per pensionet shteterore suplementare te personave qe kryejne funksione kushtetuese dhe te punonjesve te shtetit”, nr. 8661, date 18.09.2000 “Per sigurimin suplementar te policise se shtetit”, nr. 10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, te Punonjësve te Policisë se Burgjeve, te Policisë se Mbrojtjes nga Zjarri dhe te Shpëtimit e te punonjësve te Shërbimit te Kontrollit te Brendshëm ne RSH” të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar". Kontributet llogariten mbi pagen e realizuar nga keta persona, para se te fillonte trajtimi me pagese kalimtare dhe normes se kontributit per pension e barreindje te percaktuar ne ligjin nr. 7703 date 11.03.1993. ISSH, njofton ne degen e Thesarit Tirane per çdo muaj ne momentin e terheqjes se financimeve, numrin e personave qe trajtohen me pagese kalimtare , sipas evidences se derguar nga strukturat e Forcave të Armatosura, te Policisë se Burgjeve, te Policisë se Mbrojtjes nga Zjarri dhe te Shpëtimit e te Shërbimit, te Kontrollit te Brendshëm, të të Ministrisë së Rendit Publik dhe te Shërbimit Informativ Kombëtar dhe shumen e kontributit. Mbi bazen e kesaj evidence dhe kerkeses se ISSH behet kalimi i fondit nga buxheti i shtetit ne buxhetin e pavarur te sigurimeve shoqerore.
- Per ushtaraket qe trajtohen me pension te parakohshem per vjetersi sherbimi sipas ligjit nr.8087 date 13.03.1996 “Per sigurimin shoqeror suplementar te ushtarakeve te forcave te armatosura te Republikes se Shqiperise” nr. 8661, date 18.09.2000 “Per sigurimin suplementar te policise se shtetit”, nr. 10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, te Punonjësve te Policisë se Burgjeve, te Policisë se Mbrojtjes nga Zjarri dhe te Shpëtimit e te punonjësve te Shërbimit te Kontrollit te Brendshëm ne RSH” të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe Shërbimit Informativ Kombëtar". Kontributet llogariten mbi pagen referuese mbi bazen e te ciles eshte perllogaritur masa e pensionit te parakohshem dhe normes se kontributit per pension e percaktuar ne ligjin nr. 7703 date 11.03.1993.“Per Sigurimet Shoqerore ne Republiken e Shqiperise”. ISSH njofton ne degen e Thesarit Tirane per çdo muaj ne momentin e terheqjes se financimeve, numrin e ushtarakeve qe trajtohen me pension te parakohshme, te konfirmuar nga sektori i Sigurimit Suplementar prane ISSH dhe shumen e kontributit. Kalimi i ketyre fondeve behet çdo muaj nga dega e Thesarit Tirane ne Institutin e Sigurimeve Shoqerore duke kerkuar zbatimin e kritereve te pershkruara ne aktet ligjore e nenligjore perkatese si per:
- Per grate te cilave u lind e drejta ne vitin buxhetor, per aq vite sa kane kryer shkollen e larte me shkeputje nga puna. Kontributet llogariten ne baze te pages minimale te percaktuar nga Keshilli i Ministrave per efekt te pageses se kontributeve, ne vitin buxhetor dhe normes se kontributit per degen e pensioneve e percaktuar ne ligjin nr. 7703 date 11.03.1993.“Per Sigurimet Shoqerore ne Republiken e Shqiperise” ISSH depoziton ne Degen e Thesarit Tirane cdo muaj numrin e garave me arsim te larte, te pensionuara te konfirmuar nga Sektori i pensioneve prane ISSH. shumen e viteve qe trajtohen si vjetersi pune per efekt pensioni dhe shumen e kontributeve. Kalimi i ketyre fondeve ne buxhetin e sigurimeve shoqerore behet ne baze te llogaritjeve cdo muaj.

- Per punetoret e nentokes dhe te Industrise Ushtarake nen trajtim financiar te vecante. Llogaritja e kontributeve per kete kategori personash behet ne baze te pages minimale dhe normes se kontributit per degen e pensioneve e percaktuar ne ligjin nr. 7703 date 11.03.1993.“Per Sigurimet Shoqerore ne Republiken e Shqiperise” Numri i perfituesve dhe shuma e kontributeve per keto kategori depozitohet ne Degen e Thesarit Tirane nga ISSH ne bazen e nje evidence te konfirmuar nga Sektori i Sigurimit Suplementar. Kalimi i ketyre fondeve ne buxhetin e sigurimeve shoqerore behet ne baze te llogaritjeve cdo muaj.
- Financimet nga buxheti i shtetit per kompensimet qe ju jepen pensionisteve per rimbursimin e shpenzimeve nga rritja e cmimeve, pensionet e posaçme shteterore, dhe shtesat e pensioneve te posacme, shperblimet per veteranet dhe invalidet e luftes, shperblimet per invalidet e punes dhe shpenzimet per furnizimin e tyre me karburant, shpenzimet per pagesat e pensioneve suplementare te ish-funksionareve, per pagesat e pensioneve suplementare dhe te parakohshme te ushtarakeve, per pagesat e parakohshme te minatoreve, per shperblimin e familjeve te deshmorëve, per shpenzimet per pagesat e punetoreve te industrise ushtarake, per pagesat e piloteve fluturues dhe te ushtarakeve te nendeteseve, dhe te personave qe perfitojne pension suplementar per shkak te titujve shkencore, transferohen cdo muaj sipas planit por jo me shume se kufiri vjetor i shpenzimeve i miratuar nga Kuvendi.
- Per perballimin e shpenzimeve qe lidhen me dhenien e ndihmes, ne rast vdekjeje. Instituti i sigurimeve shoqerore nepermjete drejtorive rajonale dhe agjencive te sigurimeve shoqerore, kryen pagesen e kesaj ndihme, ne baze te certifikates se vdekjes se leshuar nga zyrat e gjendjes civile te njesive perkatese te qeverisjes vendore (komuna, bashki), dhe te kerkeses se paraqitur nga familjaret e personit te vdekur.
- Tranferta nga Buxheti i Shtetit per Buxhetin e ISSH, ne formen e subvecionit per kontributet e personave te vetpunesuar ne bujqesi, e subvecionit per kontributet e personave te vetpunesuar ne veprimtari ambulante, e subvecionit per kontributet e personave te punesuar si punetore shtepie dhe e subvecionit te miratur si diference midis shpenzimeve dhe te ardhurave transferohet nga buxheti i shtetit ne llogaritje e buxhetit te ISSH, sipas planit vjetor te detajuar ne muaj nga nga ISSH dhe te miratuar nga Drejtorite e buxhetit ne Ministrite e Linjes e nga Drejtoria e Pergjithshme e Thesarit ne Ministrine e Financave duke zbatuar parimin e balancimit te te hyrave me shpenzimet, por jo me shume se kufiri vjetor i subvencioneve te miratuara ne Kuvend. Pakesimi i transfertes mund te behet vetem me ndryshime ne ligjin perkates.
- Llogaritje bankare qe pasqyrojne kontributet e sigurimit shoqeror, te arketuara nepermjet Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve, konsiderohen llogari te te ardhurave buxhetit te shtetit, dhe raportohen ne fund te cdo dite nga Bankat e nivelit te dyte ne Banken e Shqiperise ne menyre te dallueshme, se bashku me te gjithe llogaritje e tjera bankare te shpenzimeve dhe te ardhurave te Buxhetit te Shtetit. Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve nepermjet strukturave te saj dergon ne strukturat pergjegjese te ISSH informacionin per kontributet e paguara dhe dokumentacionin qe verteton kontributet individuale, ne afatet dhe formatet e percaktuara ne vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 1114, datë 30.7.2008 dhe ne aktet nenligjore te dala ne zbatim te tij.
- Fondi rezerve i ISSH, i krijuar me ligj, administrohet ne nje llogari speciale ne Banken e Shqiperise. Investimi i tij kryhet nga Drejtori i Thesarit me vendim te ISSH deri ne masen e parashikuar nga dispozitat ligjore ne fuqi. Interesat e lidhura me investimin e fondit transferohen ne llogarine speciale te pagesave te ISSH ne Banken e Shqiperise. Fondi rezerve investohet ne masen dhe sipas parimeve te percaktuara ne rregulloren financiare te ISSH, te miratuar nga Keshilli Administrativ.

- Ne Banken e Shqiperise funksionon nje llogari speciale per manaxhimin e transaksioneve te pagesave te buxhetit te ISSH. Ministri i Financave cakton personat e autorizuar per te vepruar me kete llogari. Transfertat e likuiditeteve ne kete llogari do te kryhen nga Llogaria e Unifikuar e Thesarit ne BSH, periodikisht mbeshetur ne kerkesen e ISSH per furnizim te llogarise me likuiditete dhe deri ne kufirin e likuiditeteve disponibel per ISSH te derdhura si kontribut i sigurimit shoqeror.
- ISSH urdheron transferen e likuiditeteve nga llogaria speciale ne BSH, ne llogarite bankare te ne Bankat e Nivelit te Dyte, per kryerjen e transaksioneve ne buxhetet familiare dhe per buxhetin administrativ sipas programit financiar dhe procedurave te percaktuara nga ISSH.
- ISSH kryen transferta periodike te likuiditeteve ne ISKSH, ne vartesi te arketimeve ne llogarite e te ardhurave te buxhetit te Shtetit dhe ne baze te raprtit te normes se kontributit te sigurimit shendetsor ndaj normes se kontributit shoqeror dhe shebdetsor se bashku. Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve duhet te ofroje informacionin e mjaftueshem te detajuar sipas kerkesave te ISSH dhe ISKSH per arketimet ne llogarite e te ardhurave te buxhetit te Shtetit ne bankat e nivelit te dyte dhe mbi bazen e tyre ne periudha periodike behen llogaritjet e te drejtave dhe derdhjeve duke sistemuar diferencat.
- Ne fillim te cdo muaji bankat e nivelit te dyte dergojne zyrtarisht ne Ministrine e Financave (Drejtorine e Thesarit) konfirmimin per gjendjen e likuiditeteve ne llogarine e ISSH ne fund te muajit te meparshem.

114. Raporti i zbatimit te buxhetit te sigurimeve shoqerore dergohet brenda dates 7 te muajit pasardhes nga ISSH ne Drejtorine e Pergjithshme te Thesarit

4.2 Buxheti i Sigurimeve Shëndetësore

115. Buxheti i shtetit transferon ne buxhetin e sigurimeve te kujdesit shëndetësor, fonde për mbulimin e sherbimit paresor dhe kontribute për sigurimin shëndetësor për personat jo-aktiv sipas përcaktimit te tyre bere me ligjin nr.7870 date 13.10.1994 "Për sigurimet Shëndetësore".
116. Instituti i Sigurimeve te Kujdesit Shëndetësor bën detajimin ne muaj te planit te kontributit te transferuar nga buxheti i shtetit, sipas afateve dhe procedurave te parashikuara ne piken II.1 te këtij udhëzimi. Ky detajim ne nivel mujor miratohet ne Drejtorinë e Përgjithshme te Thesarit. Transfertat periodike nga buxheti qendror ne buxhetin e ISKSH kryhen nga dega e Thesarit Tirane me urdhër te Drejtorisë se Thesarit.
117. Fondi i planifikuar për dy-mujorin e pare te vitit, kalon ne forme paradhënie ne ISKSH dhe mbartet për periudhën ne vazhdim. Fondi për muajin pasardhës financohet ne baze te situacionit faktik te muajit paraardhës te paraqitur ne degën e thesarit Tirane. Diferencat mes financimit te tërhequr sipas planit dhe financimeve faktike sistemohen ne baze te situacionit faktik progresiv ne dy-mujorin e fundit te vitit, por ne asnjë rast nuk do te financohet mbi planin vjetor te miratuar ne buxhetin e shtetit.
118. Kosto e shërbimit parësor shëndetësor, si pjese përbërëse e buxhetit te sigurimeve shëndetësore, raportohet ne mënyre specifike çdo muaj nga ISKSH ne Drejtorinë e Përgjithshme te Thesarit, sipas te gjitha zërave dhe nenzerave te klasifikimit buxhetor . Pjese e raportit është edhe informacioni i përmbledhur mbi numrin e punonjësve te parashikuar dhe te realizuar ne fakt për shërbimin e kujdesit shëndetësor parësor.
119. Raporti i zbatimit te buxhetit te sigurimeve shëndetësore dërgohet brenda datës 8 te muajit pasardhës nga ISKSH ne Drejtorinë e Përgjithshme te Thesarit.
120. Llogarite bankare qe pasqyrojnë kontributet e sigurimeve shëndetësore, te arkëtuara nëpërmjet Drejtorisë se Përgjithshme te Tatimeve, konsiderohen llogari te te ardhurave te buxhetit te shtetit dhe raportohen ne fund te çdo dite nga Bankat e nivelit te dyte ne Bankën e Shqipërisë ne mënyre te dallueshme se bashku me te gjithë llogarite e tjera bankare te shpenzimeve dhe te ardhurave te Buxhetit te Shtetit.

121. Fondi rezerve i ISKSH, i krijuar me ligj, administrohet ne një llogari speciale ne Bankën e Shqipërisë. Investimi i tij kryhet nga Drejtori i Thesarit me vendim te ISKSH deri ne masën e parashikuar nga dispozitat ligjore ne fuqi. Interesat e lidhura me investimin e fondit transferohen ne llogarite e ISKSH ne bankat e nivelit te dyte.
122. ISKSH kryen transaksionet e pagesave ne llogarite e hapura nga Ministria e Financave, me kërkesë dhe ne emër te ISKSH, ne bankat e nivelit te dyte. Ne këto llogari derdhen periodikisht nga ISSH te ardhurat e arkëtuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për llogari te ISKSH, transfertat e buxhetit te Shtetit dhe te tjera te ardhura qe arkëtohen direkt nga ISKSH.
123. Ne fillim te çdo muaji bankat e nivelit te dyte dërgojnë zyrtarisht ne Ministrinë e Financave (Drejtoria e Thesarit) konfirmimin për gjendjen e likuiditeteve ne llogarinë e ISKSH ne fund te muajit te mëparshëm.

4.3 Buxheti i Pushtetit Gjyqësor

124. Ne zbatim te ligjit nr. 8363 date 1.07.1998 "Për krijimin e Zyrës se Administrimit te Buxhetit Gjyqësor", dhe te ligjit nr. 10190 date 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", detajimi fillestar i fondit te miratuar do te behet nga Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqësor dhe depozitohet ne Drejtorinë e Përgjithshme te Buxhetit dhe Drejtorinë e Përgjithshme te Thesarit, te cilat e dërgojnë për zbatim ne degët e thesarit. Transferimet për shpenzimet korrente dhe kapitale do te kryhen nga kjo Zyre dhe do te zbatohen nga degët e thesarit kur ato janë te konfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, te Ministrisë se Financave. Ne te gjitha rastet e transferimeve do te zbatohen afatet dhe procedurat e përcaktuara me sipër ne këtë udhëzim.

4.4 VENDIMET GJYQESORE

125. Për vendimet gjyqësore do te veprohet ne përputhje me Vendimin Nr.335 date 02.06.1998 "Për procedurat për zbatimin e vendimeve gjyqësore për detyrimet qe prekin buxhetin e shtetit", si dhe akte te tjera nënligjore ne këtë drejtim. Te gjitha institucionet buxhetore janë te detyruara te marrin pjese ne te gjitha shkallet e gjykimit dhe te mbajnë përgjegjësi për rezultatin e tyre. Vendimet gjyqësore zbatohen me buxhetin e miratuar te institucioneve, pasi njoftohet titullari i Ministrisë/Institucionit Qendror nga varet institucioni. Këto institucione analizojnë te gjitha vendimet qe sjellin dem efektiv për buxhetin e shtetit dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësisë. Përgjegjësia për zbatimin e vendimit gjyqësor është tërësisht e institucionit buxhetor, jo e degës se thesarit. Vendimet gjyqësore qe lidhen me privatizimin, ekzekutohen nga Ministria e Financave, nga te ardhurat nga privatizimi brenda vitit buxhetor, pavarësisht se te ardhurat nga shitja janë derdhur ne vitet e mëparshme apo ne favor te institucioneve te tjera ne përputhje me legjislacionin e kohës kur është kryer privatizimi.

4.5 Mbyllja e buxhetit te vitit 2009

126. Ne mbeshtetje te nenit 7, te Aktit Normativ nr. 10 date 23.12.2009 "Per disa ndryshime ne ligjin nr. 10025, date 27.11.2008, " P er Buxhetin e vitit 2009", te ndryshuar", e drejta per te kryer shpenzime per kompensimin e te perndjekurve politike skadon me 31 Maj 2010.
127. Për mbylljen e buxhetit te vitit 2009 ndiqet kjo procedure:
 1. Buxheti i shtetit i vitit 2009, rakordohet ne nivel grupi, titulli, kapitulli e artikulli, përfshi edhe limitin e perdorimit te te ardhurave te institucioneve buxhetore.
 2. Degët e thesarit, rakordojnë paraprakisht me njësite shpenzuese për planin vjetor te lejuar për shpenzim, përfundojnë rakordimin me Bankat e Nivelit te Dyte, Degët e Tatimeve dhe Doganave deri ne 12 Janar 2010 dhe një kopje te rakordimit, se bashku me përmbledhësen e sistemimeve qe rezultojnë nga rakordimi, e depozitojnë ne Drejtorinë e Përgjithshme te Thesarit.
 3. Degët e Thesarit dorëzojnë raportin përfundimtar te te ardhurave e shpenzimeve buxhetore ne Drejtorinë e Përgjithshme te Thesarit brenda datës 20.01.2010.

4. Njësite e Projekteve me Financime te Huaja, ISSH e ISKSH dorëzojnë raportin përfundimtar te te ardhurave e shpenzimeve ne Drejtorinë e Përgjithshme te Thesarit pranë Ministrisë se Financave brenda datës 18.01.2010.
5. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit pergatit brenda dates 20.01.2010 raportin përfundimtar te te ardhurave dhe shpenzimeve te llogarisë bankare “Depozite e Qeverise”.
6. Drejtoritë e Bankave te nivelit te dyte dërgojnë ne Drejtorinë e Përgjithshme te Thesarit, raportin vjetor mbi pagesat dhe arkëtimet e qeverise deri ne datën 15.01.2010
7. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dërgon për konfirmim akt-rakordimin përmbledhës ne Drejtoritë përkatëse te Bankave te nivelit te dyte brenda datës 22.01.2010.
8. DPTH dërgon për konfirmim aktrakordimin përfundimtar për te ardhurat e shpenzimet e vitit 2009 ne Bankën e Shqipërisë brenda datës 22.01.2010. Banka e Shqiperise konfirmon te dhenat e fundvitit deri me 25.01.2010. Ne rsat mosperputhje behen sistemimet e mundshme deri me 29.01.2010, date ne te cilen Ministri i Financave, me propozim te DPTH, miraton sistemimet per vitin 2009.
9. Deget e Thesarit nepermjet sistemit AMoFTS, deri me datën 12.02.2010, kontrollojne te gjitha shkresat e ndryshimit te planit ne nivel vjetor te Buxhetit te Shtetit te vitit 2009 dhe ne rastet e konstatimeve te gabimeve te rregjistrimeve ne sistem t'i raportojne si te tilla ne Drejtorine e Pergjithshme te Buxhetit dhe Thesarit, te cilat bejne sistemimet perkatese. Per cdo mosperputhje te ketyre planeve ne nivel programi, kapitulli, artikulli, do te behen sistemimet me Drejtorine e Pergjithshme te Buxhetit, e cila pergatit akt-rakordimin me Ministrite e Linjes/Institucionet Qendrore per planin përfundimtar vjetor deri ne daten 25.03.2010
10. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit përgatit te dhenat faktike te raportit fiskal paraprak, brenda datës 10.02.2010.
11. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe Drejtoria e Teknologjisë se Informacionit publikon te dhënat faktike (te detajuara ne nivel njësie shpenzuese) ne faqen e Internetit brenda datës 16.02.2010 te cilat do te shërbejnë për rakordim te raportit vjetor te shpenzimeve për vitin 2009 nga çdo ministri dhe institucion qendror.
12. Ministritë dhe Institucionet Qendrore deri ne datën 19.02.2010 paraqesin fillimisht ne Drejtorinë e Përgjithshme te Thesarit pranë Ministrisë se Financave mospërputhjet me situacionet përfundimtare te njesive shpenzuese (te konfirmuar nga Degët e Thesarit). Pas kalimit te këtij afati, ne rast moskonfirmimi, merren te mirëqena te dhënat faktike te publikuara ne faqen e Internetit. (www.minfin.gov.al)
13. Kur ka raste te shpenzimeve mbi ose jashtë planit, mbahet proces-verbal midis palëve rakorduese. Ne raste te argumentuara, për efekt te rakordimit dhe kur veprimi nuk sjell pasoja financiare, bëhen sistemime nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, pas miratimit nga Ministri i Financave.
14. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit përgatit te dhenat faktike te raportit fiskal përfundimtar brenda datës 05.03.2010.
15. Raporti përfundimtar i gjendjes faktike te shpenzimeve dhe te te ardhurave te Buxhetit te Shtetit i paraqitet Këshillit te Ministrave brenda datës 30 Prill 2010 dhe pas shqyrtimit te tij, i dërgohet për miratim Kuvendit brenda datës 28 Maj 2010.
16. Pas miratimit nga Kuvendi, Drejtoria e Përgjithshme e Makroekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve ne Ministrinë e Financave përgatisin Statistikat Financiare te Qeverise (buletinin vjetor dhe tabelat (GFS) sipas standardeve ndërkombëtare te përcaktuara nga FMN) brenda datës 30.06.2010.

4.6 Mbyllja e buxhetit te vitit 2010.

128. Buxheti vjetor zbatohet deri me 31 dhjetor. E drejte e njesive te qeverisjes se pergjithshme per rishperndarjen e fondeve te miratuara per vitin 2010 ushtrohet deri ne daten 15 nentor 2010. Afati përfundimtar i pranimit te Urdhër pagesave nga Degët e Thesarit është data 17 Dhjetor 2010. Mbyllja e buxhetit te vitit 2010 behet me një udhëzim te posaçem te miratuar nga Ministri i Financave.

Referuar nenit 38 te ligjit nr. 9936 date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë" : *"Ministri i Financave nxjerr urdhra, udhëzime dhe rregullore ne baze dhe për zbatim te këtij ligji"*. Ne kuptim te ligjit si me sipër, çdo udhëzim i ministrive te linjës/institucioneve qendrore, qe bie ndesh me këtë udhëzim është i pazbatueshëm nga degët e thesarit dhe nga vete institucionet buxhetore.

Ky udhëzim hyn ne fuqi menjëherë.

Ridvan BODE

MINISTER